





BASHKIA DURRËS




PLANI STRATEGJIK PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK



BASHKIA E DURRËSIT

Plani Strategjik për Zhvillimin Ekonomik

2005 – 2015





Ky plan strategjik është hartuar nga grupe të gjëra të interesuara, nga Bashkia e Durrësit nën drejtimin dhe këshillimin e Grupit të Bankës Botërore, Institutit të Shoqërisë së Hapur, LGI dhe FLAG. Grupi i Bankës Botërore, Instituti i Shoqërisë së Hapur, LGI dhe FLAG nuk mbajnë përgjegjësi për saktësinë ose përmbajtjen e strategjisë; megjithatë ato përgëzojnë bashkinë për cilësinë e punës së bërë.



Kopertina *Kilica Graphics*
Redaktorët: *Artan Rroji dhe Dr Iain Wilson*
Përkthyes *Marsela Dhimitri*
Shtypur në *Maluka shpk*

Përmbajtja	faqe
Shkurtime	5
I. Parathënie.....	6
II. Hyrje.....	7
III. Rëndësia e PSZhEV për komunitetin tonë	8
IV. Plani Strategjik.....	9
Filozofia që qëndron pas Planit Strategjik	10
V. Zhvillimi i Planit Strategjik	11
Parimet orientuese.....	11
Metodologjia	12
Proçesi i planifikimit.....	12
Forumi DELTA i Kryetarëve të Bashkive	13
Përfaqsjë organizative për hartimin e Planit Strategjik	13
Pjesëmarrja dhe konsultimi	15
Grupet e Punës në zhvillimin e Planit të ZhEV për Durrësin	16
Përmbledhje e vlerësimit të gjendjes së ekonomisë vendore.....	16
Perceptimet e bizneseve	17
Vizioni dhe Qëllimet	18
Përfitimet e pritshme	19
Zbatimi	21
Përfaqsjë organizative për zbatimin e Planit	22
Financimi i Planit Strategjik	23
VI. Vështrim i përgjithshëm mbi komunitetin e Durrësit	24
Historiku.....	24
Demografia.....	26
Arsimi.....	26
Qeveria bashkiake	27



VII. Profili ekonomik i Durrësit.....	31
Biznesi.....	31
Turizmi.....	33
Investime.....	34
Punësimi.....	36
VIII. Dokumentet përbërëse të Planit Strategjik.....	38
a. SWOT, analiza e konsoliduar	39
b. Matrica e qëllimeve, objektivave, programeve dhe projekteve të Planit.....	41
c. Matrica e zbatimit të Planit Strategjik	49
d. Matrica e prioritarizimit të projekteve.....	63
e. Fishat e projekteve.....	69
Aneksi 1: Shkurtime e përdorura në matricën e zbatimit.....	135
Aneksi 2. Raporti mbi “Anketim mbi Mjedisin në të cilin kryhet biznesi në qytet”.....	137

Shkurtime

DELTA	Drejtimi i Ekonomisë Lokale nëpërmjet Teknikave dhe Aleancave
KZhEB	Komisioni i Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë
DZhEB	Departamenti i Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë
FLAG	Fondacioni për Autonomi Vendore dhe Qeverisje
LGI	Iniciativa për Qeverinë Vendore dhe Reformën në Shërbimet Publike (pjesë e Institutit Shoqëria e Hapur e Fondacionit Soros)
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
PSZhEV	Plani Strategjik i Zhvillimit Ekonomik Vendor
SWOT	Analiza e Pikave të Forta, Pikave të Dobëta, Mundësive dhe Kërcënimeve
BB	Grupit Bankës Botërore



I. Parathënie

Programi Drejtimi i Ekonomisë Lokale nëpërmjet Teknikave dhe Aleancave (DELTA) mundësoi hartimin e strategjisë për Zhvillimin Ekonomik Vendor (ZhEV) të disa bashkive të Shqipërisë. Programi u zbatua në Shqipëri gjatë periudhës 2004–2005 dhe u mbështet financiarisht e teknikisht nga Grupi i Bankës Botërore (BB, departamenti i zhvillimit ekonomik vendor) dhe Instituti për Shoqëri të Hapur (SOROS), nëpërmjet Iniciativa për Qeverinë Vendore dhe Reformën në Shërbimet Publike (LGI), Hungari. Në bashkëpunim me organizatën shqiptare Fondacioni për Autonomi Vendore dhe Qeverisje (FLAG) u hartuan strategjitë për dhe në bashkëpunim me secilën nga bashkitë Berat, Durrës, Korçë, Lezhë dhe Shkodër. Qëllimi i programit DELTA ishte dhe vazhdon të jetë të zhvillojë plane strategjike të veprimit që do ndikojnë në reformimin e politikave të zhvillimit ekonomik vendor në nivel bashkiak, veçanërisht të sektorit privat.

Metodologjia e zbatuar nga DELTA promovon përmirësimin e mjedisit që mbështet dhe lehtëson zhvillimin e biznesit, si dhe forcimin e kapaciteteve dhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve vendore me grupet e komunitetit në përgjithësi dhe atij të bizneseve vendore në veçanti, në krijimin e vizionit të përbashkët dhe hartimin e Planit Strategjik të Zhvillimit Ekonomik Vendor (PSZhEV).

Plani Strategjik, hartuar nga secila bashki, do t'i shërbejë institucionalizimit të bashkëpunimeve private-publike dhe zhvillimit të programeve e projekteve vendore, që do të çojnë në hartimin e agjendës për një zhvillim të qëndrueshëm të bashkisë. Nëpërmjet forcimit të institucioneve, infrastrukturës dhe politikave që mbështetin ndërmarrjet private, projektet e përvijuara në PSZhEV do të ndihmojnë në zhvillimin dhe fuqizimin e Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme (NVM), rritjen e mundësive vendase për punësim në të njëjtën kohë edhe rritjen e të ardhurave për buxhetin bashkiak.

Korniza e DELTA-s i dha mundësinë kapaciteteve lokale të zhvillohen nëpërmjet rishikimit periodik të procesit të planifikimit ZhEV në mënyrë që të ketë një institucionalizim të qëndrueshëm të këtij procesi pranë qeverive bashkiake.

II. Hyrje

Ndryshimi i sistemit politik në Shqipëri, transformimi i ekonomisë vendase nga shumë e centralizuar në një variant të tregut të lirë, si dhe hapja e tregjeve dhe burimeve shqiptare ndaj atyre botërore e veçanërisht atyre evropiane, komunitetet, e veçanërisht ai i biznesit, dhe qeveritë vendore u gjetën para sfidës së ndërtimit të një ekonomie të re vendore dhe një strukture biznesi të aftë për t'ju përshtatur tregut dhe konkurrencës botërore.

Gjatë periudhës së tranzicionit të Shqipërisë, struktura e biznesit ndryshoi dhe vazhdon të ndryshojë si në nivel kombëtar dhe atë vendor. Para periudhës së tranzicionit, ndërmarrjet e mëdha publike dominuan tregun, ndërsa tani ai dominohet nga NVM. Fillimi i procesit të decentralizimit, duke lejuar qeveritë vendore të kenë një influencë më të madhe në klimën e biznesit, në mënyrë të natyrshme afruan interesat e këtyre bizneseve me politikat e qeverisë bashkiake. Çdo ditë e më shumë përgjegjësitë kryesore për ofrimin e shërbimeve dhe krijimin e rregullave lidhur me mjedisin e biznesit po transferohen nga qeveria qendrore në atë vendore.

Ky transformim i ekonomisë ka sjellë në tavolinën e punës së bashkisë një rol të ri: të udhëheqë procesin e stimulimit të rigjenerimit dhe rritjes ekonomike, duke siguruar përmirësimin në vazhdimësi të cilësisë së jetës së komunitetit nëpërmjet përmirësimit të mjedisit të biznesit vendas nga pikëpamja ekonomike dhe konkurruese.

Duke marrë parasysh këtë situatë, komunitetit po i bëhet gjithnjë e më e qartë nevoja për të bërë përpjekje më të madhe për të përcaktuar drejtimit më të rëndësishme të zhvillimit dhe të marketingut të suksesshëm të burimeve tona në mënyrë që të krijohen avantazhe konkurruese që do mbështesin bizneset ekzistuese dhe do të tërheqin biznese të reja. Kjo është e vetmja mënyrë që komuniteti ynë të mund të përdorë në mënyrë inteligjente burimet e tij me qëllim që ta bëjë sistemin e tij ekonomik të suksesshëm dhe të qëndrueshëm.

Me rëndësi në zhvillimin e tërë këtij procesi ka qenë përfshirja e drejtpërdrejtë e qeverisë bashkiake në planifikimin e ZhEV në të cilin ajo ka luajtur një rol drejtues, koordinativ dhe nxitës. Procesi u mbështet më tej nga institucionet publike të qytetit, komuniteti i biznesit, shoqëria civile dhe partnerët e tjerë nëpërmjet një pune të përbashkët e cila mundësoi krijimin e një vizioni të përbashkët dhe drejtimit më të rëndësishme të përcaktuara për garantimin e një mjedisi të përshtatshëm për ZhEV dhe që përkrah bizneset dhe shton punësimin.



III. Rëndësia e PSZhEV për komunitetin tonë

Iniciativa që mori bashkia jonë për hartimin e PSZhEV është në kuadër të përpjekjeve për ushtrimin e funksionit të saj ligjor përkrahëse dhe mbështetëse e zhvillimit ekonomik brenda juridiksionit të saj duke synuar përdorimin në mënyrë sa më efektive dhe efçente të burimeve njerëzore, natyrore, sociale, institucionale, financiare dhe fizike me qëllim krijimin e një mjedisi miqësor për banorët, bizneset e vizitorët.

Proçesi i tranzicionit kërkon ndryshime rrënjësore që duhen bërë për të përshtatur qytetin ndaj tendencave dhe kërkesave të një ZhEV të suksesshëm. Ndërkohë shumëllojshmëria e ekonomisë vendase për t'ju përshtatur kërkesave të tregut të lirë dhe dinamikat e zhvillimit të saj kërkojnë përshtatjen dhe rivlerësimin e marrëdhënieve ekzistuese mes bashkisë dhe komunitetit për të krijuar sisteme pune dhe struktura bashkëpunimi të cilat do t'i shërbejnë rehabilitimit gradual dhe konsolidimit të vazhdueshëm të një ekonomie të shëndetshme dhe të qëndrueshme në qytetin tonë.

Në këtë situatë të re ku bashkia jonë është e hapur ndaj konkurrencës kombëtare dhe ndërkombëtare për tërheqjen e bizneseve dhe krijimin e vendeve të punës, bëhet e domosdoshme përpjekja për të përcaktuar drejtimit që duhen ndjekur në të ardhmen duke u fokusuar dhe përdorur mirë burimet ekzistuese.

Qeveria vendore ka bërë edhe më parë përpjekje për të gjetur dhe bindur investues që të vinë në komunitetin tonë, por ato kanë qenë shpesh sporadike dhe të pakoordinuara mirë me faktorët e tjerë vendas apo ndonjëherë edhe ato më të largët. Përveç kësaj, përmirësimi i mjedisit vendor nga pikëpamja fizike, e cilësisë së shërbimeve, dhe stimuluesve financiarë që kërkohen për të siguruar që bizneset ekzistuese të vazhdojnë të operojnë dhe bizneset e reja që kërkojnë të operojnë ka qenë i papërshtatshëm për shkak të autoritetit të kufizuar ligjor dhe të kapaciteteve financiare të kufizuara të bashkisë.

Pavarësisht nga këto vështirësi, roli që ajo po luan ka ardhur gjithnjë duke u fuqizuar fillimisht si një vëzhgues i zhvillimeve ekonomike dhe ecurisë së biznesit në një aktor të përfshirë aktivisht në krijimin e hapësirave dhe lehtësirave në mbështetjen direkte të biznesit dhe si gjeneruesi kryesor i rritjes ekonomike dhe punësimit. Eksperienca në zhvillimin e Planit Strategjik tregoi se vetëm qeveria vendore, si autoriteti ku kulmojnë interesat politike dhe jopolitike të grupeve të ndryshme të shoqërisë, mund ta luajnë këtë rol të rëndësishëm në nxitjen e zhvillimit ekonomik duke përqafuar një mentalitet dhe përjasje të në punën e Bashkisë dhe në marrëdhëniet e saj me aktorët dhe organizatat që operojnë në komunitet.

Komuniteti ynë ka nevojë për një qeverisje vendore të zgjuar, partneritete që funksionojnë dhe një krenari civile dhe ne besojmë se strategjia aktuale ka hedhur themelet për këtë.

IV. Plani Strategjik

Ky është i pari Plan Strategjik për ZhEV që është hartuar për bashkinë tonë dhe ai përfaqëson një përpjekje për të sjellë një ndryshim në mënyrën dhe cilësinë e qeverisjes, si dhe në procesin e vendimmarrjes.

Shfrytëzimi efektiv i avantazheve ekonomike që zotëron komuniteti ynë, si dhe nxitja e tërheqja e investuesve privatë varet shumë edhe nga cilësia e qeverisjes, e shërbimeve që ofrohen, si edhe nga cilësia e politikave vendore që zhvillohen dhe zbatohen. Ato ndikojnë në infrastrukturën e shërbimeve të disponueshme për biznesin si: furnizimi me energji elektrike e ujë, transport, telekomunikacion, menaxhimi i mbetjeve dhe planifikimi urban. Fakti që pjesa më e madhe e bizneseve që operojnë në bashkinë tonë janë mikro, të vogla dhe të mesme, që varen shumë nga cilësia e shërbimeve të ofruara nga qeveria vendore, e bën rolin e mëtejshëm të bashkisë edhe më të rëndësishëm në krijimin e një mjedisi miqësor që përkrah zhvillimin e biznesit.

Ky Plan Strategjik synon të korrigjojë faktorët që kanë pasur deri tani një ndikim negativ në zhvillimin ekonomik të bashkisë dhe në cilësinë e qeverisjes vendore, dhe kështu për të reduktuar pengesat dhe uljen e rreziqeve të bërit biznes. Proçesi i planifikimit ndihmoi në vlerësimin e këtyre faktorëve dhe nëpërmjet kësaj proçedure u realizua rishikimi aktiv i bazës ekonomike dhe faktorëve zhvillues të bashkisë për të krijuar një kuptim më i mirë mbi mundësitë dhe pengesat për rritjen ekonomike dhe tërheqjen e investuesve. Gjatë këtij proçesi, partnerët tanë vlerësuan pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë dhe kërcënimet (analiza SWOT), faktorët kyç që nevojiten të adresohen me qëllim që të koordinohet zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik.

Në formulimin e Planit Strategjik, Komisioni i Planifikimit ka rishikuar burimet njerëzore dhe natyrore të disponueshme, gjendjen ekonomike të qytetit dhe zonës përreth saj, trashëgiminë kulturore dhe historike, avantazhet krahasuese, si dhe atë që komuniteti dëshiron dhe i nevojitet.

Ligji “Mbi Organizimin dhe Funksonimin e Qeverive Lokale”, Nr 8652, datë 31.07.2000, Neni 10/III, thotë se “... bashkitë do të marrin përgjegjësitë për funksionet e mëposhtme ekskluzive të Zhvillimit Ekonomik Vendor ... atë të përgatitjes së programeve për zhvillimin ekonomik lokal’ duke e bërë zhvillimin e një plani strategjik një detyrim ligjor të bashkisë.

Plani aktual u përgatit për një periudhë kohore 16 mujore. Ne e kuptojmë që përmirësimet dhe ndryshimet e dëshiruara nuk mund të ndodhin brenda një kohe të shkurtër. Megjithatë, drejtuesit e bashkisë sonë së bashku me aktorët e tjerë publikë e privat do të angazhohet për zbatimin e tij duke vërë në dispozicion burimet e nevojshme, sepse kështu ka shumë gjasa që të jetë i suksesshëm në arritjen e qëllimeve të tij.

Plani u miratua nga Këshilli i Bashkisë nëpërmjet Aktit Nr 67 të datës 23 Gusht, 2005.



Filozofia që qëndron pas Planit Strategjik

PSZhEV i bashkisë tonë synon të ka si qëllim të nxjerrë në pah vizionin dhe qëllimet strategjike për zhvillimin e qytetit, të orientojë dhe konsolidojë përpjekjet e bashkisë dhe komunitetit që të zhvillojë një mjedis mbështetës dhe favorizues për zhvillimin e biznesit në vend.

PSZhEV ynë është krijuar për të adresuar si nevojat e drejtuesve tanë ashtu dhe ato të komunitetit tonë që të përmirësojë cilësinë dhe larmi e punëve që janë të disponueshme, të përmirësojë cilësinë e jetës për qytetarët tanë dhe të mjedisit për zhvillimin e biznesit.

Bashkia dhe të gjithë aktorët e përfshirë në procesin e zhvillimit filloi të zbatonte vizionin duke u përqendruar në qëllimet parësore filozofike që gjenden pas zhvillimit të PSZhEV-it tonë:

- T'i sigurojë komunitetit dhe qeverisë vendore një dokument orientues në përcaktimin e drejtimeve të ardhshme të rritjes ekonomike;
- Të krijojë një shembull të një procesi strategjik vendimmarrës që përfshin bashkëpunimin mes politikanëve vendas, komunitetit të biznesit dhe atij më të gjerë;
- Të lehtësojë përpjekjet për bashkëpunim mes partnerëve publikë dhe privat për një zhvillim të koordinuar të bashkisë;
- Të krijojë një kornizë vendimmarrëse për çështje të tilla si shërbimet publike, infrastruktura, bashkëpunimi me biznesin;
- Të krijojë një eksperiencë të re dhe vendosjen e një kulture të planifikimit të zhvillimit ekonomik;
- Të krijojë një mjedis të favorshëm për zhvillimin dhe zgjerimin e bizneseve ekzistuese, sepse ne besojmë se në një komunitet ku bizneset ekzistuese nuk janë të kënaqura, ka pak shanse që të mund të krijohen biznese të reja;
- Të ndikojë në politikat e financimit dhe mbështetjes teknike të qeverisë qendrore dhe agjencive donatorë;
- T'i japë bashkisë sonë autoritetin e duhur drejtues që kërkohet në planifikimin e zhvillimit ekonomik;
- Të mundësojë një qeverisje vendore transparente, efektive dhe që i përgjigjet me profesionalizëm nevojave dhe kërkesave pritshmërive të banorëve dhe vizitorëve.

V. Zhvillimi i Planit Strategjik

Zhvillimi i Planit Strategjik u përfundua sipas metodologjisë së përdorur nga Grupi i Bankës Botërore. Kur përdoret procesi gjithëpërfshirës i planifikimit strategjik është e rëndësishme të arrihet një marrëveshje përfshirëse ku të ekuilibrohen nevojat ekonomike, sociale dhe mjedisore.

Parimet orientuese

Parimet që orientuan bashkinë dhe Komisionin e Planifikimit në formulimin e Planit Strategjik përfshijnë si më poshtë:

- Suksesi ekonomik balancohet me cilësinë e jetës;
- Rritja ekonomike balancohet me kërkesat sociale dhe mjedisore;
- Bashkia është një faktor kyç në përmirësimin e klimës vendore për investime;
- Bashkëpunimi midis qeverisë bashkiake, bizneseve dhe shoqërisë civile është një element kyç në progresin e qëndrueshëm ekonomik;
- Planifikim strategjik është një proces gjithëpërfshirës, i integruar dhe i institucionalizuar në bashki;
- PSZheV përcakton drejtimet kryesore për zhvillimin ekonomik, por nuk e kontrollon atë;
- Përmirësimi i të gjithë mjedisit të biznesit, dhe jo thjeshtë mbështetja e bizneseve individuale;
- Ruajtja dhe mbështetja e bizneseve ekzistuese është po aq e rëndësishme sa tërheqja e bizneseve të reja, pasi kjo përbën një marketim shumë të mirë për cilësinë e klimës së biznesit në komunitet;
- Zhvillimi i punësimit duke përdorur burimet e brendshme është më i rëndësishëm se krijimi i punësimit duke përdorur faktorët e jashtëm;
- Vendosija e partneriteteve publike–private në vendimmarrje dhe në përmirësimin e ekonomisë vendore;
- Sektorit privat gjeneruesi kryesor i zhvillimit ekonomik.



Metodologjia

Qeveria jonë bashkiake e konsideron PSZhEV si metoda më e mirë dhe sistematike e dobishme për të menaxhuar ndryshimin, për të siguruar konsensusin e komunitetit dhe për të krijuar një vizion të përbashkët për një të ardhme ekonomike më të mirë. Proçesi i planifikimit strategjik mundësoi kombinimin e përpjekjeve dhe burimet që do të çojnë në përmirësimin e situatës ekonomike dhe si rezultat, në krijimin e një kornize që synon krijimin e një mjedisi të shëndetshëm, të balancuar mirë për ekonominë dhe një cilësi të përmirësuar të jetës për qytetarët. Edhe pse përvijuar këtu kaq thjeshtë, kjo metodologji rezultoi të ishte shumë komplekse duke pasur parasysh sasinë e përpjekjeve dhe vendimmarrjen e kërkuar.

Proçesi i planifikimit strategjik u shoqërua me aktivitete të ngritjes së kapaciteteve dhe të lehtësimit të proçesit. Në funksion të ngritjes së kapaciteteve, DELTA organizoi një udhëtim studimor në Hungari ku u mbajtën tre seminare të shkurtra mbi çështjet e mëposhtme:

- Etapat dhe teknikat për zhvillimin e PSZhEV;
- Strukturat institucionale për zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e PSZhEV në partneritet me komunitetin;
- Njohja me praktikat më të mira rajonale në PSZhEV, si zhvillimi i parqeve industriale;
- Metodologjia e zhvillimit dhe prioritarizimit të projekteve.

Proçesi i planifikimit

Baza e një proçesi efektiv të planifikimit strategjik qëndron në të kuptuarit e çështjeve më të rëndësishme me të cilat përballohet komuniteti. Çështja e zhvillimit ekonomik duhet të paraqitet si një nga problemet për t'u zgjidhur, një nga nevojat për t'u adresuar dhe një nga mundësitë për t'u përdorur. Proçesi që u aplikua këtu mundësoi njësimin e opinioneve dhe zgjedhjeve të qeverisë vendore me ato të biznesit dhe agjencive të tjera përfaqësuese.

Proçesi i planifikimit u strukturua të kryhej në 5 faza:

1. Organizimi i përpjekjeve;
2. Vlerësimi i konkurrencës së ekonomisë vendore;
3. Zhvillimi i strategjisë;
4. Zbatimi i strategjisë;
5. Rishqyrtimi i strategjisë.

Proçesi i planifikimit u realizua për një periudhë 16 mujore, një proçes i cili shërbeu për identifikimin e nevojave, ideve, çështjeve dhe mundësive të zhvillimit.

Ky proçes gjatë gjithë kohëzgjatjes së tij kishte konsultime, vlerësime dhe vendimmarrje të përbashkëta në prezantimin dhe prioritetin e çështjeve kyçe të zhvillimit ekonomik të sipër përmendura.

Aktualisht Bashkia ka përfunduar tre fazat e para dhe ka filluar fazën e katërt.

Forumi DELTA i Kryetarëve të Bashkive

Gjatë zbatimit të programit DELTA, krijimi dhe funksionimi i Forumit DELTA i Kryetarëve të Bashkive ka shërbyer si katalizator në procesin e zbatimit të programit dhe si një forum ku kryetarët e bashkive dhe drejtuesit e grupit të Zhvillimit Ekonomik Vendor (ZhEV) mund të shkëmbenin eksperiencat dhe të hartonin planet e punës. Pesë forume u mbajtën gjatë procesit të planifikimit të ZhEV. Me qëllim lehtësimin e shkëmbimit të informacionit, kryetarët e bashkive ranë dakord se një mjet shumë i rëndësishëm do të ishte krijimi dhe mirëmbajtja e një faqeje interneti për secilën nga pesë bashkitë e përfshira në programin DELTA.


Përfaqja organizative për hartimin e Planit Strategjik

Përfaqja organizative për hartimin e Planit ishte e tillë që mundësoi një vendimmarrje direkte dhe të institucionalizuar të një grupi të gjerë personash ku bënin pjesë përfaqësues të komunitetit, Kryetari i Bashkisë, anëtarë të Këshillit Bashkiak dhe staf i qeverisë bashkiake.

Institucionalizimi i kësaj pjesëmarrjeje u krye nëpërmjet Komisionit të Planifikimit të Zhvillimit Ekonomik (ose KZhEB, Komisioni i Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë) i ngritur dhe kryesuar nga Kryetari i Bashkisë. Roli i Komisionit ishte të hartonte e të rishikonte Planin, dhe kjo përgjegjësi vazhdon me mbikëqyrjen dhe vlerësimin e zbatimit të tij. Struktura e Komisionit u ndërtua e tillë që mundësoi grupimin e anëtarësisë sipas fushave dhe grupeve të interesit.

Element kyç i kësaj strukture ishte dhe mbetet Grupi Kryesor i drejtuar nga Drejtoria e Zhvillimit Koordinimit (DZhEB) dhe ku komuniteti i biznesit ka një përfaqësues. Grupi Kryesor luajti një rol kyç në koordinimin e punës midis anëtarëve të komisionit me partnerët e DELTA dhe me agjencitë dhe organizatat në nivel vendor e qendror, të interesuara dhe të angazhuara në zhvillimin e bashkisë.

Struktura organizative e KZhEB tregohet në figurë në faqen që vijon.



Pjesëmarrja dhe konsultimi

Formulimi i dokumentit të Planit Strategjik ka qenë synimi kryesor i Bashkisë. Por ajo pati si qëllim edhe përfshirjen e aktorëve të tjerë të cilët do të kishin një rol vendimtar në zhvillimin e strategjisë. Do të ishte e pamundur për Bashkinë të realizonte e vetme të gjithë procesin. Prandaj ishte e nevojshme përfshirja e ekspertizës së njerëzve të tjerë nga komuniteti të cilët mund të ofronin në proces lloje të ndryshme ekspertizash dhe eksperiencash, në mënyrë që të siguroheshim që personave më të aftë në komunitet t'i ofrohej mundësia për të dhënë alternativa për adresimin e çështjeve më kritike të rritjes dhe zhvillimit ekonomik vendor.

Në total, 50 njerëz nga komuniteti morën pjesë, 35 nga të cilët në mënyrë direkte, në procesin e planifikimit, duke përfshirë përfaqësues të bashkisë, komuniteti i biznesit, bankat, institucionet mësimore, ndërmarrjet publike, OJF-të si dhe qytetarë të tjerë të njohur në komunitet për nivelin e tyre të ekspertizës dhe kontributin në shoqëri.

Qeveria bashkiake bëri një përpjekje të madhe për të mbajtur të angazhuar dhe të fokusuar këtë grup të gjerë aktorësh gjatë gjithë procesit të planifikimit strategjik të cilët dhanë ndihmë të paçmuar në formulimin e draft Planit Strategjik.

Si rezultati i kësaj përfshirjeje, pjesëmarrja direkte e njerëzve jashtë qeverisë lokale të cilët kontribuuan në proces i dha Planit Strategjik një pronësi të plotë lokale.

Sigurimi i mbështetjes politike është prioriteti i punës sonë. Për këtë qëllim, ne kontaktuam Kryetarin e Këshillit Bashkiak dhe Komisionin e Këshillit për Zhvillimit Ekonomik dhe i informuam për projektin, mbështetjen që kërkohej dhe përjasjen e punës për zbatimin e projektit.

Gjatë zbatimin të projektit grupet e punës përgatitën informacione të zgjeruara të cilat u paraqitën në anëtarëve të këshillit me informacione mbi hapat dhe progresin e hartimit të planit strategjik.

Kualifikimi, përgatitja dhe trajnimi profesional i të gjithë njerëzve të përfshirë në proces u realizuan nëpërmjet formave të ndryshme dhe nën drejtimin kompetent të ekspertëve të fushave. Për këtë qëllim, tre seminare kryesore, mbledhje të ndryshme në disa zona dhe një udhëtim në Hungari u zhvilluan dhe këtij synimi i sherbeu edhe Forumi DELTA i Kryetarëve të Bashkive.

Në takimet e KPZHEV morën pjesë përfaqësues nga biznesi, arsimit, kultura, bujqësia, tregtia, ndërtimi, transporti dhe shoqëria civile të cilat shërbyen për të mbledhur mendimet, propozime, sugjerime të cilat më pas u reflektuan në formulimet e Planit Strategjik.



Grupi Kryesor punoi në mënyrë efikase edhe me median si atë televizive dhe të shkruar. Media u konsiderua si një mjet i rëndësishëm mbështetës për progresin e PSZhEV. Disa nga takimet e e KPZHE u transmetuan në televizionin lokal të Durrësit.

Si rezultati i kësaj përfshirjeje, pjesëmarrja direkte e njerëzve jashtë qeverisë bashkiake të cilët kontribuan në proces i dha Planit Strategjik një pronësi të plotë vendore.

Grupet e Punës në zhvillimin e Planit të ZhEV për Durrësin

Grupi i Biznesit

Mehmet Bakalli	Banka Kombëtare Greke
Armando Mustafa	Banka Pro-Credit
Vangjel Papajorgji	Banka e Tiranës
Hajdar Kovaci	Presidenti i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë
Sami Gjergji	Sektori i prodhimit
Armando Duka	Sektori i prodhimit
Sokol Kallogjeri	Sektori i prodhimit
Genci Mataj	Sektori i transportit
Astrit Duci	Sektori i transportit
Vangjush Dako	Sektori i ndërtimit
Bujar Haznedari	Sektori i tregëtisë
Gafurr Dudaj	Sektori i shërbimeve
Andrea Xhovara	Qendra për Primovimin e Biznesit dhe Ekonomisë

Grupi i Agjencive Publike

Nadire Kertusha	Drejtori i Shëndetit Publik
Vladimir Vrahoriti	Korporata Energjitike Shqiptare
Artan Zaimi	Ndërmarrja Ujës-jellës Kanalizime

Grupi i Komunitetit

Bashkim Hoxha	Gazetar dhe shkrimtar
Tasim Besho	Profesor i Ekonomisë
Jurgen Treska	Arkitekt
Edgar Frasheri	Arkitekt
Kujtim Kumbaro	Ekonomist
Gezim Agasi	Ekonomist
Sali Hidri	Profesor i Historisë dhe Arkeologjisë
Afrim Hoti	Asistent Profesor dhe Drejtor i Arkeologjisë
Gani Limanaj	Ekonomist
Marenglen Rrapi	Jurist

Grupi i Shoqërisë Civile

Silvia Fadda	UNOPS
Illir Zela	TAULEDA
Edi Zografi	ICMC
Oriana Arapi	Co-Plan
Elsa Gryka	Kryqi i Kuq
Miriam Recic	CSDC
Bajana Cevoli	Shoqata e Gruas me Probleme Sociale
Myzejen Konduri	Shoqata "Gruaja, Koha dhe Ekonomia"
Elvira Ajazi	Forumi i Gruas së Pavarur, Dega Durrës

Përmbledhje e vlerësimit të gjendjes së ekonomisë vendore

Vlerësimi i kushtet aktuale të ekonomisë vendore në Durrës ishin subjekti i një analize SWOT (pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë dhe kërcënimet), e cila shqyrtoi të dhënat bazë ekonomike dhe sociale, si dhe pikëpamjet vendore të shprehura në një sondazh biznesi dhe ato të shprehura nga Komisioni i Planifikimit. Analiza SWOT u përdor si platformë për zhvillimin e Planit Strategjik.

Të dhënat e mbledhura përfshinin statistikën dhe informacionet në lidhje me burimet vendore, natyrore, njerëzore dhe financiare, strukturën e ekonomisë dhe të biznesit, nivelin dhe strukturën e punësimit dhe arsimit, si dhe kualifikimet e fuqisë së aftë për punë. Një grup i kualifikuar njerëzish, kryesisht nga bashkia, u angazhuan në mbledhjen e informacionit, një proces ky jo i lehtë për shkak të situatës aktuale në lidhje me informacionin dhe sektorin statistikor.

Një aspekt i veçantë në proces për të siguruar besueshmërinë e të dhënave ishte organizimi nga ana e FLAG e punës për anketimn e komunitetin të biznesit vendor. Përfundimet u përdorën nga grupet e punës së PSZhEV si dhe nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë.

Pasi u mblodh materiali u përpunua së bashku me rezultatet që shërbyen për përgatitjen e Planit. Nëpërmjet kësaj analize, doli më i qartë drejtimi që do të merrte Strategjia e Zhvillimit. Informacioni ishte në dispozicion të grupeve të punës dhe ato organizonin mbledhje të koordinuara javore.

Gjatë zhvillimit të kësaj analize Komisioni i Planifikimit bëri një vlerësim sektorial të ekonomisë vendore ku u angazhuan ekipet e punës. Analizimi i situatës vendore u vazhdua nga anëtarët e Komisionit të Planifikimit në mbledhjet e KPZHEV ku u identifikuan avantazhet dhe sfidat kryesore me të cilat përballet komuniteti në ecurinë e rritjes ekonomike.

Gjatë analizës Grupi i Studimit përgatiti një pamje të përgjithshme të dhënave bazë ekonomike dhe sociale si dhe tregues të tjerë.

Perceptimet e bizneseve

Qeveritë bashkiake kanë mandatin e promovimit të zhvillimit të NVM vendase. Megjithatë, ky mandat konsiderohet nga sektori privat si i kufizuar ligjërisht sidomos përse i përket sigurimit të burimeve për ndërmarrjen e aktiviteteve të biznesit.

Për të hyrë pak më thellë në këtë çështje dhe për të kuptuar shqetësimet e biznesit vendas më në detaje, në qytet u krye një anketim. Qëllimi i anketimit ishte mbledhja e informacionit dhe e pikëpamjeve të komunitetit të biznesit mbi situatën ekonomike në vend, perspektivën e të bërit biznes këtu, kushtet dhe rregullat që ndikojnë në zhvillimin e bizneseve vendase, politikën dhe praktikën që pengojnë zhvillimin e bizneseve ekzistuese, si dhe kërkesat e nevojat e komunitetit për përmirësimin e klimës së biznesit.

Anketimi mbi Mjedisin Vendor në të cilit Kryhet Biznesi u zhvillua në Mars–Prill 2004 dhe **96 biznese** nga kategori të ndryshme morën pjesë në të.



Perceptimi kryesor i bizneseve është se qeveritë vendore nuk kanë mjetet e duhura ose autoritetin e duhur për të ndihmuar zhvillimin e NVM. Ky perceptim del në pah nga mungesa e komunikimit dhe dialogu i varfër midis qeverisë vendore dhe biznesit.

Përfshirja e mendimit të biznesit në formulimin e Planit Strategjik ishte një etapë e rëndësishme në hapjen e procesit të vendim-marrjes. Nëpërmjet këtij hapi, mendimet e një grupi njerëzish që kanë influencën më të madhe mbi zhvillimin ekonomik të bashkisë u morën.

U intervistuan pak më shumë se 3 për qind e 3,019 bizneseve të regjistruara në bashki nga të cilat 26 ishin biznese prodhuese, 25 merreshin me tregti, 31 ofronin shërbime dhe 14 ishin biznese ndërtimi. Këto biznese kanë qenë aktive për një periudhë kohore që varionte nga një deri në trembëdhjetë vjet, ku shumica prej tyre vepron nga katër deri në tetë vjet. Nga të intervistuarit 75 ishin pronarë, tetë ishin drejtorë të përgjithshëm dhe trembëdhjetë ishin menaxherë të lartë. Ndërmjet këtyre bizneseve 23 kishin një pronar dhe 73 më shumë se një pronar. Më shumë se gjysma e bizneseve (52) kishin më pak se pesë të punësuar (zakonisht një), 19 kishin gjashtë deri në dhjetë të punësuar, 16 kishin nga njëmbëdhjetë deri në 50 të punësuar, shtatë kishin më shumë se 50 të punësuar dhe dy biznese kishin më shumë se 200 të punësuar.

Vizioni dhe Qëllimet

Vizioni

Qëllimi i përcaktimit të vizionit për zhvillimin tonë ekonomik vendor ishte që t'i mundësonte komunitetit tonë të artikulojë se ku ai dëshiron të jetë në të ardhmen dhe çfarë rruge do të ndjekë për të arritur atje. Vizioni do t'u japë qytetarëve dhe Bashkisë një ide të qartë se çfarë duhet bërë dhe ku duhen përqendruar energjitë dhe burimet e komunitetit.

Vizioni u zhvillua nga Komisioni i Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë (KZhEB) pas konsultimeve me segmente të ndryshme të komunitetit dhe pasi u prezantua publikisht nëpërmjet mediave lokale. Synimi ishte të zhvillohej një vizion i cili të mund të pranohet nga sa më shumë aktorë dhe grupe interesi të mundshëm dhe që do të sigurojë një përshkrim të hollësishëm të ardhmes së preferuar ekonomike të qytetit tonë.

Ky vizion tenton të jetë një ëndërr e cila i ka rrënjët në realitetin natyror, gjeografik, ekonomik, historik e kulturor të Bashkisë. Ai synon të përmbushë pritshmëritë dhe aspiratat e komunitetit dhe të përcaktojë një drejtim të qartë për zhvillimin e qytetit dhe ne besojmë së ai përmbledh në mënyrë realiste dëshirat dhe kapacitetet e këtij komuniteti. Ne synojmë që këtë vizion ta ndajmë në vazhdimësi me grupe të komunitetit në mënyrë që ai të pranohet edhe më shumë dhe të kthehet në një udhërrëfyes drejt realizimit të kësaj ëndrre.

Vizioni do të jetë objekt i vlerësimit të mëvonshëm nga komuniteti dhe vendim-marrësit e Bashkisë për të reflektuar ndryshimet e vlerësimeve, dëshirave dhe rrethanave.

Qëllimet

Përcaktimi i qëllimeve të ZhEV na ndihmon të marrim vendime lidhur me rrugët dhe mënyrat për të arritur ndryshimet që nevojiten. Megjithëse disa nga qëllimet dhe veprimet për arritjen e tyre nuk lidhen direkt me krijimin e vendeve të punës dhe me zhvillimin dhe tërheqjen e bizneseve, e ardhmja e komunitetit tonë bazohet mbi themele të shëndosha si niveli i arsimimit dhe cilësia e jetës, infrastruktura dhe shërbimet bashkiake. Në konceptin tonë, bizneset nuk zhvillohen, nuk lulëzojnë dhe nuk mund të tërhiqen në komunitete ku nuk ofrohen nivele dhe cilësi e përshtatshme e infrastrukturës dhe shërbimeve që kërkon një mjedis i mirë për zhvillimin e biznesit.


Për të arritur qëllimet e ZhEV, bashkia ynë është përqendruar në përdorimin e burimeve të veta natyrore dhe njerëzore. Për zhvillimin e qëllimeve, Komisioni i Planifikimit mori parasysh mundësitë dhe sfidat me të cilat ballafaqohet bashkia, historinë e vet të zhvillimit ekonomik dhe të rajonit.

Qëllimet e ZhEV shprehin drejtimit kryesore që do të ndjekë zhvillimi i bashkisë. Këto janë renditur në faqen tjetër sipas rëndësisë për ZhEV dhe krijimit të një mjedisi të favorshëm. Ato janë zhvilluar me anën e një analize logjike të kujdesshme të vizionit dhe trajtojnë çështje thelbësore për zhvillimin e qytetit.

Përfitimet e pritshme

Përfitimet që priten si rezultat i zbatimit të Planit tonë Strategjik janë të shumëfishta, por më kryesoret janë si më poshtë:

- Orientimi i Këshillit Bashkiak dhe administratës së bashkisë në procesin e buxhetimit vjetor dhe afatmesëm duke u fokusuar në zbatimin e projekteve të përfshirë në PSZhEV;
- Fokusimi tek burimet njerëzore dhe financiare në fushat e identifikuara duke rritur maksimalisht përfitimet dhe mundësuar arritjen e qëllimeve dhe objektivave të PSZhEV;
- Fuqizimi i partneritetit të qëndrueshëm në vendimmarrje me bashkëfinancim të bashkisë dhe komunitetit të biznesit;
- Rritja e kapaciteteve të administratës së bashkisë dhe veçanërisht të DZhEB;



- Koordinimin e aktiviteteve të organizatave dhe agjencive të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e pjesëve të ndryshme të PSZhEV;
- Përcaktimi i një kalendari realist për zbatimin e PSZhEV;
- Identifikimi i rezultateve të pritshme;
- Zhvillimin e një sistemi eficient komunikimi mes bashkisë dhe partnerëve të saj;
- Lehtësimin e marketimit të potencialeve dhe të mundësive që të bëhet biznes në qytet;
- Krijimin e një sistemi monitorues në bashkëpunim me komunitetin me qëllim ndjekjen e aktiviteteve dhe vlerësimin të rezultateve të parashikuara nga PSZhEV;
- Përmirësimin e sistemit të menaxhimit në bashki në funksion të zbatimit të programeve të përfshira në matricën e Planit;
- Orientimin e grupimit dhe të negocimit me aktorët vendorë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë që janë të interesuar ose që janë përfshirë në projekte në PSZhEV;
- Orientimin e Bashkisë dhe donatorëve në dhënien e fondeve dhe në përqendrimin tek burimet ekzistuese të disponueshme.

Zbatimi

PSZhEV përbën planin zyrtar për administrimin e çështjeve të Bashkisë, institucioneve dhe ndërmarrjeve që ajo nën varësi dhe si i tillë, është një plan që zhvillohet vazhdimisht. PSZhEV për qytetin tonë ka filluar dhe do të ndjekë katër faza:

1. Aktivizimi i burimeve të financimit dhe dhënia e fondeve;
2. Realizimi i partneriteteve publiko-private;
3. Monitorimi dhe vlerësimi i Planit;
4. Rivlerësimi dhe përmirësimi i Planit.

Duke qenë se afati i zbatimit të PSZhEV është më i gjatë se mandati politik, sukcesi i zbatimit të strategjisë do të varet shumë nga angazhimi i vazhdueshëm i Bashkisë dhe shoqërisë civile në arritjen e objektivave dhe zbatimin e projekteve të përvijuara.



Këshilli bashkiak, si faktori kyç në mbështetjen e PSZhEV, do të garantojë dhënien e fondeve bashkiake për financimin e projekteve. Përveç kësaj, ai do të ofrojë mbështetje edhe për miratimin e përmirësimeve që do të sugjerohen nga Komisioni i Planifikimit dhe ekzekutivi i Bashkisë.

Kryetari i Bashkisë me mbështetjen e shefit të DZhEB do të koordinojë programet, projektet dhe financimet e qeverisë qendrore, donatorëve dhe organizatat vendase dhe të huaja në mënyrë që ato të ndjekin dhe mbështesin PSZhEV. Përveç kësaj, ata do të iniciojnë dhe do të realizojnë përmirësimet e mjaftueshme në menaxhimin e procesit dhe do të ristrukturojnë stafin në funksion të zbatimit të PSZhEV. Suksesi i zbatimit të Planit do të varet më së shumti nga mënyra se si organizatat dhe agjencitë e përfshira në zbatimin e Planit Strategjik do të menaxhojnë elementët veçantë për të cilat ata janë përgjegjës.

Ndërkohë që komuniteti do të përjetojë progres si pasojë e zbatimit të PSZhEV, vetë plani do të ketë nevojë të rishikohet, vlerësohet dhe përmirësohet për të adresuar situatat dhe kushtet e reja. Komisioni i Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë (KZhEB) do të monitorojë dhe vlerësojë zbatimin e Planit duke mbajtur në mendje faktin se edhe komuniteti duhet të marrë pjesë në procesin e monitorimit.

Përqasja organizative për zbatimin e Planit

Bashkia caktoi KZhEB si organizmin kryesor që do të rishikojë dhe vlerësojë procesin e zbatimit të Planit Strategjik. Çdo katër muaj KZhEB do të mblidhet për të diskutuar ecurinë e zbatimit të Planit bazuar në raportet e përgatitura nga DZhEB. Ai, çdo vit në muajin Gusht, do të diskutojë dhe miratojë gjetjet, vlerësimet dhe do të shtojë sugjerimet për përmirësime të cilat do t'i paraqiten Kryetarit të Bashkisë e më pas Këshillit të Bashkisë për diskutim e miratim.

Përbërja e komisionit mund të ndryshojë. Megjithatë, funksionet e tij do të mbesin të njëjta: mbështetje, monitorim dhe rishikim i zbatimit të Planit. Ndërkohë, kryetari i bashkisë në konsultim me KZhEB, mund të emërojë grupe pune për të ndihmuar këtë të fundit në zbatimin e pjesëve të veçanta.

KZhEB do të zhvillojë dhe miratojë një plan pune vjetor për rishikimin e Planit Strategjik. Fondet për veprimtarinë e saj do të miratohen nga Këshilli Bashkiak mbi bazën e kërkesës së Kryetarit të Bashkisë.

DZhEB është struktura direkt përgjegjëse për të ndjekur procesin e zbatimit të planit, dhe kryesisht:

- do të sigurojë logjistikën e nevojshme administrative për aktivitetin e KZhEB;
- do të koordinojë aktivitetet e aktorëve të identifikuar në Plan dhe të atyre që do të përfshihen më vonë;

- do të sigurojë personel për grupet e punës që do të punojnë pranë KZhEB;
- do të përgatisë dhe paraqesë para Kryetarit të Bashkisë dhe KZhEB raportet mbi përmbushjen e procesit të zbatimit të planit;
- do të sigurojë të dhëna dhe informacione që kërkohen nga Kryetari i Bashkisë dhe KZhEB.

Financimi i Planit Strategjik

Financimi i zbatimit të Planit Strategjik përbën një përpjekje të madhe për bashkinë po aq sa edhe hartimi i tij. Matrica e Zbatimit të Planit (Kapitulli VIIIc) identifikon kostot e përlllogaritura dhe paraqet partnerët aktualë potencialë në financimin e tij. Kostoja e përafërt e zbatimit të Planit llogaritet në 16,413,166,015 Lekë, e barabartë me 131,305,328 Euro.

Qeveria Bashkiake do ta ketë me prioritet financimin e Planin Strategjik nga buxheti i saj dhe ky ka filluar tashmë në vitin 2005. Këshilli bashkiak do të vazhdojë të përfshijë zbatimin e programeve dhe projekteve të Planit në buxhetet vjetore dhe afatmesme të Bashkisë.

Plani Strategjik do të bashkë financohet nga qeveria qendrore, komuniteti i biznesit dhe grupe të tjera të komunitetit, donatorë e organizata vendase dhe të huaja. Angazhimi me investime direkte të komunitetit të biznesit ofron një garanci financiare më shumë në zbatimin dhe suksesin e tij.



VI. Vështrim i përgjithshëm mbi komunitetin e Durrësit

Historiku

Durrësi është një nga qytetet më të vjetra të Shqipërisë, porti detar kryesor i vendit dhe qendra e dytë më e madhe industriale e tij. Ai vjen i dyti për nga madhësia e popullsisë (167,000) në vend, pas Tiranës. Qyteti shtrihet ($41^{\circ}19'V$, $19^{\circ}27'L$) në një gadishull të vogël në brigjet e detit Adriatik dhe u themelua në vitin 627 para Krishtit nga kolonizatorët e Korinthit dhe të Korkirës (Korfuzi i sotëm), në zonën e një vendbanimi të lashtë të fisit ilir të Taulantëve. Ai ka marrë shumë emra: Epidamn, Dyrrah dhe Dyrrakium, nga të cilët vjen edhe emri i sotëm. Duke pasur marrëdhënie të mira tregtare me vendet e tjera, qyteti dhe popullsia e madhe e tij ilire lulëzuan.

Që nga shekulli V P.K., Durrësi ka prodhuar metale, qeramika, copa dhe lëkurë, si dhe ka patur kantiere detare për ndërtimin dhe riparimin e anijeve. Në kohët e lashta, Durrësi ishte një qytet-shtet me skllëvër dhe një klasë skllavopronare. Monedhat e vjetra të gjetura në zonën e Durrësit janë provë e zhvillimit ekonomik të asaj periudhe dhe ai ishte qyteti që hodhi në qarkullim Dhrahminë ilire. Artet dhe arkitektura lulëzuan: mozaiku “Bukuroshja e Durrësit” është një nga artefaktet më të famshme që është gjetur. Në vitin 229 P.K., Durrësi ra nën diktatin e Romës, por ai e ruajti gjysmë autonominë derisa u bë koloni e plotë romake gjatë sundimit të Augustit, rreth vitit 20 P.K. Gjatë asaj periudhe popullsia vendase ilire mori pushtetin politik dhe arriti të merrte disa pozicione të larta administrative, ashtu si tregohet edhe në shumë nga emrat ilirë të gjetur në gurët e varreve dhe mbishkrime të tjera.

Durrësi u zhvillua gjatë periudhës ndërmjet shekujve I dhe III P.K. duke u bërë një nga qendrat dhe portet kryesore tregtare në brigjet lindore të Adriatikut. U zhvilluan zejtaritë dhe rrugët, bibliotekat, u ndërtuan ujësjellës dhe odeone, përfshirë këtu edhe Amfiteatrin. Në fund të shekullit III, Durrësi u bë qendra e provincës së Epirit të Ri dhe në shekullin IV, pavarësisht nga krizat që ndikuan në pjesën tjetër të Perandorisë Romake, ai mbeti një qendër e zhvilluar tregtare. Gjatë shekujve V dhe VI, ai ishte një qytet i rëndësishëm në pjesën perëndimore të Perandorisë Bizantine dhe që u rezistoi sulmeve të Ostrogotëve dhe barbarëve të tjerë. Nën sundimin e Anastasit, i cili lindi në qytet, u ndërtuan shumë ndërtesa të reja, si për shembull hipodromi, dy mure rrethues të qytetit dhe bazilika në Arapajt. Durrësi ishte gjithashtu edhe një qendër e peshkopëve.

Ndërmjet shekujve X dhe XIV, qyteti u bë objekt i një serie sulmesh (nga bullgarët ndërmjet viteve 989 dhe 1005; nga normanët, në vitin 1082 dhe 1083, të cilët i vunë zjarrin në 1185; nga Venediku më 1205, nga e cila u krijua edhe Dukati i Durrësit; nga Çarlsi i Anzhuve në 1272, i cili themeloi Mbretërinë e Arbërisë me kryeqendër të saj Durrësin; si edhe nga serbët në fillim të shekullit XIV). Në shekullin XIV, Durrësi ishte qyteti më i madh i Shqipërisë, me rreth 25,000 banorë. Në 1368, u mor nga Karl Topia dhe u bë qendra e Principatës së Arbërit. Në 1392, qyteti i njohur tani si Durrazzo, u

kthye nën sundimit të Venedikut. Ushtria osmane, e drejtuar nga Mehmeti II e rrethoi qytetin më 1466 por nuk u mori deri më 1501, kohë në të cilën qyteti ishte shkatërruar nga sulmet e ndryshme ndër shekuj. Megjithatë, ai e ruajti rëndësinë e një limani natyror dhe lidhjet e tij me krahinat në brendësi të vendit dhe përgjatë Rrugës Egnatia deri në Selanik dhe Kostandinopojë (Bizanti) duke lidhur lindjen me perëndimin, u përtëritën.

Durrësi është dëmtuar disa herë nga tërmetet: në vitin 345 P.K., 1372, 1905 dhe 1926. Gjatë dhe pas viteve 1870, qyteti u rrit ngadalë ekonomikisht ku një rëndësi të pati hapja e degëve të kompanive të huaja të anijeve. Banorët e Durrësit morën pjesë në lëvizjen kombëtare çlirimtare të Shqipërisë, gjatë viteve 1878–1881 dhe përsëri më 1910–1912. Në 21 Nëntor 1912 Ismail Qemali erdhi në Durrës dhe më 26 Nëntor flamuri shqiptar i pavarësisë u ngrit në qytet, por ai u pushtua menjëherë tre ditë më vonë nga serbët. Serbët qëndruan deri në Maj 1913. Me 7 Mars 1913, Durrësi u bë kryeqyteti i Shqipërisë. Pas rënies së Vilhelm Vidit, princit austriak të caktuar si mbret i Shqipërisë nga fuqitë evropiane, Durrësi u bë skena e shumë kryengritjeve. Në vitin 1916 ai u pushtua nga forcat austro-hungareze dhe më 1918 nga forcat italiane. Gjatë nëntë shekujve të fundit, Durrësi ka kaluar 33 herë nga dora e një sunduesi tek tjetri.

Pas Luftës së Parë Botërore, në Dhjetor 1918, në Durrës u mbajt një kongres kombëtar dhe u caktua një administratë e përkohshme e qytetit, por ajo ra në Janar 1920 pas Kongresit të Lushnjës. Qytetarët e Durrësit morën pjesë në luftimet në Vlorë dhe në lëvizjet demokratike të viteve 1921–1924. Gjatë sundimit të Mbretit Zog, financime italiane rrodhën në Durrës, dhe u ndërtuan shumë fabrika, si ato të prodhimit të miellit, cigareve dhe makaronave. Pas dëmit të madh të tërmetit në Dhjetor 1926, u ndërtuan rrugë të gjera dhe qyteti mori një pamje të ngjashme me atë që ka sot, veçanërisht pranë portit. Gjatë viteve 1930, Durrësi shënoi një zhvillim të qëndrueshëm, nga 4,700 banorë që kishte në 1923 deri në 10,500 në 1938. Gjatë vitit 1939, ishte qendra e rezistencës kundër forcave fashiste italiane që kishin pushtuar vendin. Shumë demonstrata dhe greva u organizuan në qytet dhe në vitin 1942 u formua këtu Këshilli i Çlirimit Kombëtar. Në Gusht 1943, qyteti u pushtua nga gjermanët të cilët në të vitin që pasoi e hodhën në erë portin.

Pas Luftës së II Botërore, Durrësi u transformua në një qytet industrial dhe u bë një qendër e rëndësishme kulturore dhe arsimore. Sot, industritë kryesore janë inxhinieritë mekanike dhe kimike, elektronike dhe mobilieri, plastika, prodhimi dhe përpunimi i gomës dhe ushqimit. Durrësi prodhon verë, cigare, peshk, anije të tonazhit të madh, trena mallrash, motorë elektrikë, pajisje radio dhe televizori, artikuj plastike dhe gome, etj.

Qyteti ka një jetë kulturore të kënaqshme ku përveç bibliotekës së qyteti, qendrës kulturore dhe teatrit “Aleksandër Moisiu”, Durrësi ka teatrin e estradës dhe teatrin e kukullave, një orkestër filarmonike, ansamblin e Durrësit dhe shumë grupe të tjera artistike. Muzeumet kryesore që operojnë janë ndërtuar



muzeumi arkeologjik dhe ai historik, ndërkohë që shtëpia e familjes së Aleksandër Moisiut është kthyer tashmë në një ambient muzeal të vizitueshëm. Durrësi ka shumë shoqata shkencore dhe dega e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve është aktive në qytet.

Gjatë viteve 1990–1991 Durrësi është zgjeruar si në veri dhe në lindje, me shumë ndërtime të reja publike dhe rezidenciale ndërkohë që monumentet e pjesës së vjetër të qytetit janë ruajtur. Zona kryesore industriale ndodhet në hyrjen lindore të qytetit, në zonën e Shkozetit. Durrësi ka shumë ambiente të gjelbëra brenda të cilave spikat teatër veror i ndërtuar në kodrat mbi qytetit. Zonat kryesore të argëtimit janë Plazhi i Durrësit dhe Plazhi i Currilave, ku qytetarët dhe turistët i kënaqen rërës së verdhë dhe plazheve të Adriatikut.

Demografia

Ndryshimet demografike që ndodhën në Durrës ndërmjet viteve 1990 dhe 2004 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Viti	Banorët	Meshkuj	Femra	Familjet
1990	87,559	43,940	43,619	22,570
1991	90,790	45,556	45,234	23,992
1992	95,046	47,646	47,400	25,985
1993	97,383	48,659	48,724	
1994	100,005	49,876	50,133	
1995	103,568	51,580	51,989	
1996	124,323	62,415	61,908	
1997	132,841	67,031	66,105	
1998	137,993	69,315	69,069	
1999	142,417	71,500	70,914	
2000	149,877	75,334	74,557	
2001	158,713	79,744	78,969	
2002	166,874	83,774	83,100	
2004	175,468	88,261	87,207	47,817

Arsimi

Nr 85	Projekti Q4:O2:PG1:p1: Hartimi i udhëzimeve për administrimin e artefakteve të nëndheshme me rëndësi arkeologjike, historike dhe kulturore	Lloji i programit Q4:O2:PG1: Shtimi i numrit të monumenteve kulturore të vizitueshme nga turistët
Përshkrim i shkurtër i projektit Ky projekt synon hartimin e një rregulloreje të re që merr parasysh kërkesat e ligjit të vitit 2003 “Për mbrojtjen e monumenteve historike dhe trashëgimisë kulturore në Shqipëri”. Pjesa e dytë e projektit do të përcaktojë se cilat vende arkeologjike të cilat kanë nevojë të mbrohen dhe të specifikojë seksionet e tyre më të rëndësishme. Rëndësia e vendosjes së kushteve të tilla është se kjo do të mundësojë bazën për ndërhyrjet që do të bëhen në vendet me rëndësi të veçantë. Kryerja paraprake e gërmimeve arkeologjike është një parakusht për të gjitha ndërtimet e reja dhe nëse zbatohet me korrektësi, kjo do të arrijë ruajtjen dhe restaurimin e monumenteve që ende nuk janë zbuluar.		
Rezultatet e pritshme Koordinimi dhe mbikëqyrja e rreptë e punës për ndërtimin e reja për të garantuar zbatimin e kërkesave ligjore Harmonizimi i stilit të zhvillimeve të sotme urbane me arkitekturën antike dhe mesjetare		Grupet e synuara Bashkia Firma ndërtimi Arkeologë Arkitektë Urbanistë
Aktorët e mundshëm Instituti i Monumenteve të Kulturës Instituti i Arkeologjisë Universiteti i Parmës Donatorë		Kontribuesit e mundshëm në projekt Bashkia Donatorë Arkeologë
Para kushtet Rregullorja e re duhet të zbatohet kërkesat e ligjit mbi trashëgiminë kulturore dhe të ligjit për zhvillimin urban		Faktorë rrezikues Të pa identifikuar
Shpenzimet e llogaritura		
Totali		1,000,000 Lekë
Personi i kontaktit për projektin Drejtorja e Urbanistikës pranë Bashkisë		
Koha e zbatimit Viti 2006		Periudha e pritjes së rezultatit 2007

Nr 86	Projekti Q4:O2:PG1:p2: Ndërtimi i një sheshi për vendosjen e grupit skulpturor për figurat e shquara të qytetit	Lloji i programit Q4:O2:PG1: Shtimi i numrit të monumenteve kulturore të vizitueshme nga turistët
Përshkrim i shkurtër i projektit Qyteti i Durrësit është vendlindja e disa figurave të shquara politike dhe kulturore të qytetit, si për shembull: Perandori Anastasi I (430–518), reformator i taksave, ndërtoi Murin Anastasian në perëndim të Konstandinopojës, një shembull i rrallë i fortifikimit linear monumental në kontinentin Evropian, vjen pas Murit të Hadrianit përsa i përket kompleksitetit të tij; Jan Kukuzeli (1280–1375), kompozitor bizantin; Andrea Aleksi (1425–1506), arkitekt dhe skulptor i periudhës së Rilindjes; Aleksander Moisiu (1879–1935), aktor evropian i teatrit dhe filmit.		
Rezultatet e pritshme Rritja e interesit të publikut, veçanërisht e të rinjve për historinë e qytetit të tyre		Grupet e synuara Të gjithë komunitet Turistët Studentët
Aktorët e mundshëm Bashkia Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve		Kontribuesit e mundshëm në projekt Shoqëria civile UNESCO UNDP UNOPS
Para kushtet Krijimi i një sheshi dhe përpilimi i një projekti ndërtimor		Faktorë rrezikues Mungesa e një plani urban për zhvillimin e qytetit
Shpenzimet e llogaritura Totali		50,000,000 Lekë
Personi i kontaktit për projektin Drejtorja e Urbanistikës pranë Bashkisë		
Koha e zbatimit Viti 2006		Periudha e pritjes së rezultatit 2007



Nr 87	Projekti Q4:O3:PG1:p1: Organizimi i javës së aktiviteteve për të festuar trashëgiminë kulturore të qytetit	Lloji i programit Q4:O3:PG1: Përtëritja sistematike e vlerave të trashëgimisë kulturore, historike dhe arkeologjike
<p>Përshkrim i shkurtër i projektit</p> <p>Gërmimet e ndërmarra në qytetin e Durrësit si edhe monumentet e tij arkeologjike dhe historia e pasur, kanë një vlerë të pamasë për trashëgiminë kulturore të Shqipërisë.</p> <p>Ky projekt, i cili në javën e fundit të Shtatorit përket me Ditën Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore, do të ndërmarrë disa aktivitete për të ruajtur dhe mbrojtur monumentet kulturore të qytetit. Aktivitetet do të marrin formën e një festivali dhe do të kenë një ndikim pozitiv në informimin e publikut dhe në shpërndarjen e dijeve për trashëgiminë kulturore të qytetit. Aktivitetet do të prezantojnë të gjitha zhvillimet e fundit në fushën e arkeologjisë në Durrës, dhe duke bërë kështu do të bëhet e mundur informimi i më shumë njerëzve si edhe inkurajimi i lidhjeve mes institucioneve kulturore dhe shkollave.</p>		
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p>Rritja e ndërgjegjësimit publik për studimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore Inkurajimi i lidhjeve midis institucioneve dhe shkollave</p>		<p>Grupet e synuara</p> <p>Shkollat Komuniteti i bashkisë Turistët Komuniteti i biznesit</p>
<p>Aktorët e mundshëm</p> <p>Muzeu Arkeologjik Instituti i Monumenteve të Kulturës OJF vendase dhe të huaja</p>		<p>Kontribuesit e mundshëm në projekt</p> <p>Drejtoria Arsimore Rajonale Fondacione e shoqata të ndryshme</p>
<p>Para kushtet</p> <p>Organizimi i seminareve të trajnimit për arsimtarët dhe specialistët e kulturës Organizimi i aktiviteteve që do të ndihmojnë në mirëmbajtjen dhe pastrimin e Amfiteatrit, tregut dhe kështjellës Vlerësimi i objekteve arkeologjike të qytetit Vënia në dispozicion e kasetave audiovizive</p>		<p>Faktorë rrezikues</p> <p>Buxheti i mjaftueshëm</p>
<p>Shpenzimet e llogaritura</p> <p>Totali 5,000,000 Lekë</p>		
<p>Personi i kontaktit për projektin</p> <p>Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Sporteve</p>		
<p>Koha e zbatimit</p> <p>Viti 2005</p>		<p>Periudha e pritjes së rezultatit</p> <p>Viti 2006</p>

Nr 88	Projekti Q4:O3:PG1:p2: Organizimi i një simpoziumi ndërkombëtar të titulluar “Durrësi dhe rajoni Adriatiko-jonian gjatë epokës së lashtësisë dhe mesjetës”	Lloji i programit Q4:O3:PG1: Përtëritja sistematike e vlerave të trashëgimisë kulturore, historike dhe arkeologjike
Përshkrim i shkurtër i projektit Ky projekt do të përqendrohet në organizimin e një simpoziumi për të paraqitur dhe diskutuar aspektet e zhvillimeve historike dhe kulturore të qytetit të Durrësit në lidhje me qendrat e tjera në rajonin Adriatiko-jonian gjatë epokës së lashtësisë dhe asaj mesjetare. Përveç studiuesve vendas do të jenë të pranishëm historianë dhe arkeologë ndërkombëtarë. Temat e simpoziumit do të përfshijnë: “Lidhjet kulturore dhe tregtare mes Durrësit dhe qytet-porteve të tjera”; “Dyrrahu dhe lufta civile romake”; “Flotat në lashtësi dhe në mesjetë e Dyrrahut”; “Durrësi - një kryqëzim mes Lindjes dhe Perëndimit”.		
Rezultatet e pritshme Hulumtimi dhe reklamimi ndërkombëtar i vlerave historike dhe kulturore të Durrësit Botimi i akteve të simpoziumit në një vëllim të veçante		Grupet e synuara Historianët kombëtarë dhe ndërkombëtarë Studentet
Aktorët e mundshëm Bashkia Departamenti Arkeologjisë, Durrës Drejtoria e Muzeve Durrës		Kontribuesit e mundshëm në projekt Fondacionet e ndryshme Sponsorizime biznesi
Para kushtet Përgatitja e abstrakteve		Faktorë rrezikues Buxheti i pamjaftueshëm
Shpenzimet e llogaritura		
Totali		3,000,000 Lekë
Personi i kontaktit për projektin Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Sporteve		
Koha e zbatimit Maj 2006		Periudha e pritjes së rezultatit Pas simpoziumit



Nr 89	Projekti Q4:O3:PG1:p3: Organizimi i përvitshëm i Karnavaleve	Lloji i programit Q4:O3:PG1: Përtëritja sistematike e vlerave të trashëgimisë kulturore, historike dhe arkeologjike
Përshkrim i shkurtër i projektit Është në qëllimin e këtij projekti përfshirja e të gjitha shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të qytetit në organizimin e karnavaleve të përvitshme. Nxënësit e shkollave do të punojnë në mënyrë të pavarur për të dhënë kontributin e tyre në paradë e cila do të nisë nga sheshi “Taulantia”. Pjesëmarrësit do të parakalojnë përgjatë bulevardit kryesor të Durrësit, të veshur sipas një game të gjerë kostumesh interesantë.		
Rezultatet e pritshme Rritja e pjesëmarrjes së studentëve në aktivitetet social-kulturore	Grupet e synuara Të rinjtë Komuniteti i bashkisë Turistët	
Aktorët e mundshëm Bashkia Drejtoria Arsimore Rajonale	Kontribuesit e mundshëm në projekt Biznesit vendas	
Para kushtet Interesi i shkollave për të marrë pjesë në karnavale	Faktorë rrezikues Kushtet e motit	
Shpenzimet e llogaritura		
Totali	500,000 Lekë	
Personi i kontaktit për projektin Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Sporteve		
Koha e zbatimit Viti 2006	Periudha e pritjes së rezultatit Gjithë viti shkollor	

Nr 90	Projekti Q4:O3:PG1:p4: Organizimi i përvitshëm i “Ditës së Gladiatorëve”	Lloji i programit Q4:O3:PG1: Përtëritja sistematike e vlerave të trashëgimisë kulturore, historike dhe arkeologjike
Përshkrim i shkurtër i projektit		
<p>Amfiteatri i Durrësit është një nga thesaret më të mëdhenj të Shqipërisë. Gjatë sundimit romak, qyteti përjetoi një nga periudhat me zhvillimin më të madh ekonomik.</p> <p>Ky projekt synon të vendosë organizimin e një festivali të përvitshëm mbështetur në historinë e amfiteatrit. Është menduar që në organizimin e spektakleve do të ishte me interes të madh aktrimi në skenën ekzistuese. Qyteti do të kishte kështu mundësinë t’i ofronte diçka unike jo vetëm vendit, por edhe vendeve të tjera evropiane. Gjatë periudhës dy apo tre ditore, do të organizohen aktivitete të ndryshme të cilat simbolizojnë trashëgiminë historike dhe kulturore të qytetit.</p>		
Rezultatet e pritshme	Krijimi i një aktiviteti tradicional që feston të kaluarën e lashtë të qytetit Rritja e ndërgjegjësimit të banorëve për vlerat e qytetit	Grupet e synuara Të rinjtë e bashkisë Turistët I gjithë komuniteti
Aktorët e mundshëm	Bashkia Ambasada Italiane Universiteti i Parmës, Itali	Kontribuuesit e mundshëm në projekt Ambasada Italiane Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
Para kushtet	Koordinimi i aktoreve të mundshëm	Faktorë rrezikues Koordinim i dobët i projektit
Shpenzimet e llogaritura	Totali	18,750,000 Lekë (ne vitin e pare, 6,250,000 Lekë çdo vit me pas)
Personi i kontaktit për projektin		
Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Sporteve		
Koha e zbatimit	Shtator 2006– Shtator 2007	Periudha e pritjes së rezultatit Çdo Shtator



Nr 91	Projekti Q4:O3:PG1:p5: Përgatitja dhe publikimi i enciklopedisë së qytetit të Durrësit	Lloji i programit Q4:O3:PG1: Përtëritja sistematike e vlerave të trashëgimisë kulturore, historike dhe arkeologjike
Përshkrim i shkurtër i projektit Ky projekt synon në publikimin e një enciklopedie të Durrësit. Libri do të jetë një punë gjithëpërfshirëse, që nga kohët e lashta deri në ato moderne. Ai do të prezantojë një përmbledhje të historisë së qytetit dhe banorëve të tij, tiparet kryesore të zhvillimit historik dhe politik të qytetit, si edhe të personaliteteve të tij në fushën e kulturës, ekonomisë dhe politikës, me kontributet e tyre në vend dhe jashtë tij. Durrësi, një nga qytetet me të lashtë të vendit tonë, ka qenë një qendër e rëndësishme administrative për shumë shekuj, dhe ka qenë një nga pikat kryesore të kontaktit midis Lindjes dhe Perëndimit, një urë kryesore lidhëse mbi Adriatik si edhe një nga portet më të rëndësishme. Shumë nga personalitetet historike të fushave të ndryshme e kanë marrë emrin e qytetit në një mënyrë apo tjetër për mbiemrin e tyre. Epidamnus, Dyrrahu dhe Dyrrakium është tani i njohur si Durrës.		
Rezultatet e pritshme Prodhimi i antologjisë me informacion të kohëve të fundit mbi qytetin duke përfshirë gjetjet nga kërkimet e fundit	Grupet e synuara Studentët Mësuesit Studiuesit e historisë dhe kulturës	
Aktorët e mundshëm Bashkia OJF Donatorë	Kontribuesit e mundshëm në projekt Bashkia Institutet shtetërore Donatorë	
Para kushtet Sigurimi i mundësive kërkimore dhe i shërbimeve administrative të nevojshme Disponueshmëria e ekspertëve për të kryer kërkimet dhe shkruar dokumentet	Faktorë rrezikues Mungesa e fondeve Mungesa e një laboratorit fotografik	
Shpenzimet e llogaritura Totali	18,750,000 Lekë	
Personi i kontaktit për projektin Drejtorja e Arsimit, Kulturës dhe Sporteve		
Koha e zbatimit Katër vjet	Periudha e pritjes së rezultatit Gjithë kohës mbas botimit	

Nr 92	Projekti Q5:O1:PG1:p1: Ndërtimi i Galerisë së Artit	Lloji i programit Q5:O1:PG1: Shtimi në qytet i numrit të mjediseve kulturore dhe arsimore
<p>Përshkrim i shkurtër i projektit</p> <p>Ndërtimi i një Galerie Arti është tani një çështje urgjente për njerëzit në Durrës sepse pasuria e arteve pamore të qytetit ruhet në mënyrë të papërshtatshme dhe rrezikon të dëmtohet çdo ditë e më shumë. Ky projekt synon ta rregullojë këtë situatë fillimisht duke zgjedhur vendin me një sipërfaqe të përshtatshme jo më pak se 300 metër katrorë, dhe pastaj duke ndërtuar galerinë. Një tjetër mundësi është përdorimi i ndërtesës që do të jetë biblioteka.</p>		
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p>Inkurajimi i piktorëve të rinj Paraqitja e historisë së arteve pamore të Durrësit</p>		<p>Grupet e synuara</p> <p>Piktorët e qytetit Artdashësit</p>
<p>Aktorët e mundshëm</p> <p>Bashkia Donatorë</p>		<p>Kontribuuesit e mundshëm në projekt</p> <p>Dhoma Tregtisë e Industrisë Komuniteti</p>
<p>Para kushtet</p> <p>Vëzhgimi i kritereve për ruajtjen e veprave të artit</p>		<p>Faktorë rrezikues</p> <p>Mungesë e ndërtesës ose tokës së përshtatshme</p>
<p>Shpenzimet e llogaritura</p> <p>Totali</p>		<p>24,000,000 Lekë</p>
<p>Personi i kontaktit për projektin</p> <p>Drejtorja e Urbanistikës pranë Bashkisë</p>		
<p>Koha e zbatimit</p> <p>Viti 2006</p>		<p>Periudha e pritjes së rezultatit</p> <p>Pa kufizuar mbas ndërtimit</p>



Nr 93	Projekti Q5:O1:PG1:p2: Ndërtimi i bibliotekës së re të qytetit	Lloji i programit Q5:O1:PG1: Shtimi në qytet i numrit të mjediseve kulturore dhe arsimore
Përshkrim i shkurtër i projektit Biblioteka e Durrësit gëzon statusin e kategorisë së parë. Gjithsesi, qyteti ka përjetuar ndryshime të mëdha gjatë një dekade e gjysmë. Për më tepër ndërtesa ku ndodhet sot biblioteka aktuale është pronë private. Kështu që është e nevojshme të ndërtohet një bibliotekë e re. Ky projekt synon në ndërtimin një biblioteke të re publike, e cila do të ofrojë shumë shërbime të reja si salla leximi, shërbim interneti, ambiente ekspozimi etj. Ky projekt do të ndihmojë që gjithnjë e më shumë individë të grupmohave të ndryshme të kenë mundësi më të mira për të përdorur librat.		
Rezultatet e pritshme Më shumë libra për t'u përdorur nga të gjitha moshat	Grupet e synuara Komuniteti i bashkisë	
Aktorët e mundshëm Bashkia Universiteti i Parmës, Itali UNOPS Donatorë	Kontribuuesit e mundshëm në projekt Bashkia Donatorët e ndryshme	
Para kushtet Ndjekja e modelit të funksionimit të bibliotekës publike	Faktorë rrezikues Mungesa e fondeve	
Shpenzimet e llogaritura		
Totali		75,000,000 Lekë
Personi i kontaktit për projektin Drejtorja e Urbanistikës pranë Bashkisë		
Koha e zbatimit Vitet 2006–2007	Periudha e pritjes së rezultatit Vazhdon mbas zbatimin e projektit	

Nr 94	Projekti Q5:O1:PG1:p3: Rikonstruksioni i Pallatit të Kulturës	Lloji i programit Q5:O1:PG1: Shtimi në qytet i numrit të mjediseve kulturore dhe arsimore
<p>Përshkrim i shkurtër i projektit</p> <p>Kjo ndërtesë historikisht ka qenë një pikë kontakti për aktivitetet kulturore të ndërmarra në qytet. Mjediset tani janë në gjendje shumë të keqe dhe kanë nevojë urgjente të riparohen. Ky projekt synon të bëjë rikonstruktimi e ndërtesës në tërësi. Ai do të përqendrohet në: Rikonstruksionin e mjediseve të brendshme si dhe të fasadës; Rikonstruksionin e sallës, skenës, mjediseve të tjera ndihmese, etj.</p>		
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p>Funksionimi i mjediseve për organizimin e aktiviteteve kulturore, politike dhe argëtuese Rritja e numrit të shikuesve Rritja e të ardhurave</p>		<p>Grupet e synuara</p> <p>Artistet Komuniteti i teatrit Komuniteti i bashkisë</p>
<p>Aktorët e mundshëm</p> <p>Bashkia</p>		<p>Kontribuuesit e mundshëm në projekt</p> <p>Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve</p>
<p>Para kushtet</p> <p>Përgatitja e planeve të detajuar për projektin</p>		<p>Faktorë rrezikues</p> <p>Mungesë koordinimi</p>
<p>Shpenzimet e llogaritura</p> <p>Totali 62,500,000 Lekë</p>		
<p>Personi i kontaktit për projektin</p> <p>Drejtoria e Urbanistikës pranë Bashkisë</p>		
<p>Koha e zbatimit</p> <p>Vitet 2005–2006</p>		<p>Periudha e pritjes së rezultatit</p> <p>2006 e në vazhdim</p>



Nr 95	Projekti Q5:O1:PG2:p1: Rehabilitimi kompleksit sportive të qytetit	Lloji i programit Q5:O1:PG2: Inkurajimi i sporteve për të gjithë
Përshkrim i shkurtër i projektit Ky projekt synon të bëjë rikonstruksionin e mjediseve dhe terreneve sportive në parkun sportiv të qytetit. Ngritja e fushave të basketbollit, volejbollit, tenisit, etj.		
Rezultatet e pritshme Vënia në dispozicion e mjediseve sportive për rininë Vënia në funksionim e kompleksit sportiv sipas standardeve bashkëkohore		Grupet e synuara Komuniteti i bashkisë Të rinjtë
Aktorët e mundshëm Bashkia Klubet sportive		Kontribuuesit e mundshëm në projekt Komuniteti biznesit Sportistet
Para kushtet Përgatitja e planeve të detajuar për projektin		Faktorë rrezikues Koordinim i dobët ndërmjet aktorëve
Shpenzimet e llogaritura		
Totali		1,250,000 Lekë
Personi i kontaktit për projektin Drejtorja e Urbanistikës pranë Bashkisë		
Koha e zbatimit Viti 2006		Periudha e pritjes së rezultatit 2007 e në vazhdim

Nr 96	Projekti Q5:O1:PG2:p2: Ndërtimi i qendrës së sporteve të ujit	Lloji i programit Q5:O1:PG2: Inkurajimi i sporteve për të gjithë
<p>Përshkrim i shkurtër i projektit</p> <p>Ndërtimi i qendrës së sporteve ujore është shumë e rëndësishme për qytetin duke pasur parasysh rëndësinë e ujit në jetën e tij të përditshme, historinë e tij dhe pozicionin si vendi kryesor për turistët. Ky projekt synon të ndërtojë një qendër të tillë sipas standardeve moderne me mjedise cilësore për stërvitje dhe kampionate, si kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Është planifikuar të ndërtohen: pishinë e mbuluar, dhoma zhveshje, dushe, tabelë elektronike për rezultatin, sistem publik i adresës, mjete për shpëtim si dhe një pishinë e hapur.</p>		
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p>Ofrimi i një qendre bashkëkohore të sporteve ujore</p>		<p>Grupet e synuara</p> <p>Komuniteti i bashkisë Sportistët e Durrësit</p>
<p>Aktorët e mundshëm</p> <p>Bashkia Komuniteti i biznesit vendas Donatorë</p>		<p>Kontribuuesit e mundshëm në projekt</p> <p>Bashkia</p>
<p>Para kushtet</p> <p>Përcaktimi i terrenit për ndërtesën Planifikimi i projektit në detaje</p>		<p>Faktorë rrezikues</p> <p>Buxhet i pamjaftueshëm</p>
<p>Shpenzimet e llogaritura</p> <p>Totali</p>		<p>6,000,000 Lekë</p>
<p>Personi i kontaktit për projektin</p> <p>Drejtorja e Urbanistikës pranë Bashkisë</p>		
<p>Koha e zbatimit</p> <p>Viti 2006</p>		<p>Periudha e pritjes së rezultatit</p> <p>Vazhdon mbas zbatimin e projektit</p>



Nr 97	Projekti Q5:O1:PG2:p3: Ndërtimi i 10 fushave të mini-futbollit	Lloji i programit Q5:O1:PG2: Inkurajimi i sporteve për të gjithë
Përshkrim i shkurtër i projektit Ky projekt synon të kryejë ndërtimin e dhjetë minifushave të futbollit në mjediset e shkollave të qytetit dhe do të ketë bashkëpunimin ndërmjet bashkisë së Durrësit me Federatën Shqiptare të Futbollit.		
Rezultatet e pritshme Përmirësimi i mjediseve stërvitore në shkollat e zonës Përmirësimi i mjediseve për lojra në shkollat e zonës		Grupet e synuara Nxënësit
Aktorët e mundshëm Bashkia Federata Shqiptare e Futbollit		Kontribuuesit e mundshëm në projekt Prindërit Komuniteti biznesit
Para kushtet Respektimi i standardeve të ndërtimit, sigurisë dhe atyre shkollore		Faktorë rrezikues Mungesë koordinimi me ndërmarrjen ujësjellës dhe kanalizime
Shpenzimet e llogaritura		
Totali		18,750,000 Lekë
Personi i kontaktit për projektin Drejtorja e Urbanistikës pranë Bashkisë		
Koha e zbatimit Vitet 2005–2006		Periudha e pritjes së rezultatit Vazhdon mbas zbatimin e projektit

Nr 99	Projekti Q5:O2:PG1:p2: Krijimi i një parku të gjelbër midis kodrave të qytetit	Lloji i programit Q5:O2:PG1: Përfshirja e komunitetit të biznesit për të bashkëfinacuar zgjerimin e zonave të gjelbëra
Përshkrim i shkurtër i projektit Ky projekt do të krijojë një zonë të gjelbër dhe të zbukuruar që do të shërbejë për argëtimin e të gjithë qytetit si edhe për tërheqjen e turistëve.		
Rezultatet e pritshme Krijimi i zonave të gjelbëra argëtuese		Grupet e synuara Komuniteti i bashkisë Turistet vendore dhe të huaj
Aktorët e mundshëm Bashkia Komuniteti i biznesit vendas Donatorë		Kontribuuesit e mundshëm në projekt Bashkia Zyra e Projektit
Para kushtet Përcaktimi i vendndodhjeve Lirimi i mjediseve nga ndërtimet e paligjshme		Faktorë rrezikues Konflikte mbi pronësinë e tokës
Shpenzimet e llogaritura Totali		10,000,000 Lekë
Personi i kontaktit për projektin Drejtoria e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë		
Koha e zbatimit Viti 2007		Periudha e pritjes së rezultatit 2008 e në vazhdim



Nr 100	Projekti Q5:O2:PG1:p3: Krijimi i këndeve të gjelbëra në zonat e banuara dhe në sheshet publike	Lloji i programit Q5:O2:PG1: Përfshirja e komunitetit të biznesit për të bashkëfinancuar zgjerimin e zonave të gjelbëra
Përshkrim i shkurtër i projektit Ky projekt synon në shtimin e sipërfaqeve të gjelbra në qytet, duke synuar kështu në përmirësimin e jetës të komunitetit dhe të mjedisit në qytet. Projekti është përgatitur tashmë nga Drejtoria e Urbanistikës pranë Bashkisë në bashkëpunim me specialistë të Ndërmarrjes Shërbimeve Komunale Durrës. Puna që duhet bërë përfshin përmirësime ose ndërtim të rrugëve dhe shesheve, këndeve të lojërave, minifutboll e tenis, ndriçues dekorativ, vende për parkim si dhe parqe me bar, bimësi dekorative dhe stola, etj.		
Rezultatet e pritshme Përmirësimi rrënjësor i mjedisit Përmirësimi i kanalizimeve dhe kullimit të ujërave të zeza		Grupet e synuara Komuniteti i bashkisë
Aktorët e mundshëm Bashkia Donatorët Komuniteti i bashkisë		Kontribuuesit e mundshëm në projekt Bashkia Donatorë të ndryshëm
Para kushtet Përpilimi i projektit Sigurimi i fondeve Miratimi i projektit Tenderimi i fondeve për këtë projekt		Faktorë rrezikues Mosmirëmbajtja nga komuniteti Neglizhenca në shërbimet që duhet ti kryhen objektit
Shpenzimet e llogaritura Totali		18,750,000 Lekë
Personi i kontaktit për projektin Drejtoria e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë		
Koha e zbatimit Vitet 2006–2007		Periudha e pritjes së rezultatit Vazhdon mbas zbatimin e projektit

Nr 101	Projekti Q5:O2:PG1:p4: Ndërtimi i lulishtes tek shkolla “Qemal Mici”	Lloji i programit Q5:O2:PG1: Përfshirja e komunitetit të biznesit për të bashkëfinancuar zgjerimin e zonave të gjelbëra
Përshkrim i shkurtër i projektit		
Ky projekt synon në përmirësimin e zonave për zbavitjen e fëmijëve në shkollën “Qemal Mici” si dhe në sigurimin në shkollë të një zone të gjelbër.		
Sistemimi i gjelbërimit në zonën e mbetur të shkollës do të përfshijë mbjelljen e luleve dekorative, vendosjen e stolave dhe bordurave, bërjen e rrugicave dhe shesheve të asfaltuara me dekor. Kopshti do të ketë një sipërfaqe prej 180 m ² , dhe do të përmbajë 14 pemë dekorative dhe 14 shkurre si oleandër, ligustrina, etj.		
Rezultatet e pritshme Përmirësimi i kushtet e pushimit dhe argëtimit të nxënësve Përmirësimi i pamjes estetike të shkollës	Grupet e synuara Nxënësit Mësuesit	
Aktorët e mundshëm Bashkia Drejtoria Arsimore Rajonale Programi Zviceran	Kontribuuesit e mundshëm në projekt Qeverisë Donatorë	
Para kushtet Kopshti të ndërtohet gjatë verës Miratimi nga autoritetet e duhura	Faktorë rrezikues Mos miratimi i fondeve	
Shpenzimet e llogaritura		
Totali		5,000,000 Lekë
Personi i kontaktit për projektin Drejtoria e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë		
Koha e zbatimit Viti 2007	Periodha e pritjes së rezultatit Vazhdon mbas zbatimin e projektit	



Nr 102	Projekti Q5:O2:PG1:p5: Ndërtimi i fidanishtes	Lloji i programit Q5:O2:PG1: Përfshirja e komunitetit të biznesit për të bashkëfinacuar zgjerimin e zonave të gjelbëra
Përshkrim i shkurtër i projektit Qëllimi i këtij projekti është krijimi i një fidanishteje për bimët dekorative të përshtatshme për klimën dhe kushtet e truallit në qark. Madhësia e fidanishtes është planifikuar të jetë rreth 10,000 m ² . Fidanishtja do të kultivojë çdo vit rreth 500 pemë nga dhjetë lloje të ndryshme, si edhe 1,000 shkurre dekorative. Pemët do të rriten në 120 parcela të vogla toke dhe shkurret në 50 parcela. Secila pemë ose shkurre do të rrethohet me bimësi dekorative dhe tela. Aty do të ketë rreth 1,000 m ² rrugëza dhe zona përpunimi. Tipet e bimëve që parashikohen të kultivohen janë: plama, pisha, akacie, trëndafila, manjola, selvi, ligustrina, etj.		
Rezultatet e pritshme Rritja e bimëve dekorative për vendet dhe lulishtet publike të qytetit Çmime më të ulëta se në tregun privat	Grupet e synuara Komuniteti i bashkisë Bizneset e turizmit	
Aktorët e mundshëm Bashkia Ndërmarrja Shërbimit Komunal Donatorë	Kontribuuesit e mundshëm në projekt Bashkia Donatorë të ndryshëm	
Para kushtet Gjetja e territori dhe caktimi i tij për fidanishte Sigurimi i fondit përkatës	Faktorë rrezikues Mos miratimi i fondeve	
Shpenzimet e llogaritura		
Totali		4,600,000 Lekë
Personi i kontaktit për projektin Drejtorja e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë		
Koha e zbatimit Viti 2007	Periudha e pritjes së rezultatit 2007 e në vazhdim	

Nr 105	Projekti Q5:O3:PG2:p1: Përfshirja e Kënetës brenda zonës së shërbimit të pastrimit	Lloji i programit Q5:O3:PG2: Sigurimi, në bashkëpunim me komunitetin, i infrastrukturës dhe shërbimeve bazë në Kënetë
Përshkrim i shkurtër i projektit Ky projekt synon në shtimin e gamës së shërbimeve të ofruara nga bashkia për komunitetin e zonës së Kënetës në Durrës. Në mënyrë të veçantë, ai do të lehtësojë në pastrimin e kësaj zone banimi, si edhe në mirëmbajtjen e saj pas ofrimit të këtyre shërbimeve.		
Rezultatet e pritshme Rritja e cilësisë së jetesës të komunitetit		Grupet e synuara Komuniteti i zonës
Aktorët e mundshëm Bashkia Komuniteti i zonës Donatorët		Kontribuesit e mundshëm në projekt Bashkia Ndërmarrja e Pastrimit dhe Gjelbërimit
Para kushtet Përgatitja e infrastrukturës dhe rritja e sensibilizimit të komunitetit		Faktorë rrezikues Infrastrukturë e dobët
Shpenzimet e llogaritura		
Totali		4,400,000 Lekë
Personi i kontaktit për projektin Drejtorja e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë		
Koha e zbatimit Vitet 2005–2007		Periudha e pritjes së rezultatit Vazhdon mbas zbatimin e projektit



Nr 106	Projekti Q5:O3:PG2:p2: Përmirësimi i infrastrukturës së rrugës kryesore në Kënetë	Lloji i programit Q5:O3:PG2: Sigurimi, në bashkëpunim me komunitetin, i infrastrukturës dhe shërbimeve bazë në Kënetë
Përshkrim i shkurtër i projektit Ky projekt synon në përmirësimet që do të bëhen në infrastrukturën e zonës informale të banimit të ndërtuara në zonë dhe rrotull moçalishte që shtrihet në rrethinat të qytetit. Ndërtimi i dy akseve kryesore rrugore që lidh unazën e qytetit me autostradën do të përfshijë dhe do t'i shërbejë zonës së banimit.		
Rezultatet e pritshme Përmirësimi i infrastrukturës së zonës Përmirësimi i cilësisë së jetës për komunitetin e zonës	Grupet e synuara Komuniteti i zonës Komuniteti i biznesit të zonës	
Aktorët e mundshëm Bashkia Ministria e Transporteve Komuniteti i zonës	Kontribuesit e mundshëm në projekt Bashkia Zyra e Projektit	
Para kushtet Shkatërrimi i ndërtimeve joligjore të zonës ilegal	Faktorë rrezikues Kjo është moçalishte dhe kërkon aplikimin e standardeve të përshtatshme të infrastrukturës	
Shpenzimet e llogaritura		
Totali		25,000,000 Lekë
Personi i kontaktit për projektin Drejtorja e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë		
Koha e zbatimit Viti 2006	Periudha e pritjes së rezultatit 2007 e në vazhdim	

Nr 107	Projekti Q5:O3:PG2:p3: Ndërtimi i një shkolle 9-vjeçare në Kënetë	Lloji i programit Q5:O3:PG2: Sigurimi, në bashkëpunim me komunitetin, i infrastrukturës dhe shërbimeve bazë në Kënetë
Përshkrim i shkurtër i projektit Zona informale e banimit të Kënetës ndodhet pranë dhe rreth moçalishte. Përveç kësaj, komuniteti vendas ka vështirësi në përdorimin e shkollave për fëmijët e zonës. Ky projekt synon në ndërtimin në këtë zonë e një shkolle 9-vjeçare të ndërtuar sipas standardeve moderne.		
Rezultatet e pritshme Përhapja dhe krijimi i kushteve për arsimimin e fëmijëve të zonës	Grupet e synuara Komuniteti i zonës Nxënësit e zonës	
Aktorët e mundshëm Ministria e Arsimit dhe Shkencës Bashkia	Kontribuuesit e mundshëm në projekt Bashkia Ministria e Arsimit dhe Shkencës	
Para kushtet Përgatitja e vendit ku do të ndërtohet shkolla	Faktorë rrezikues Kjo është një moçalishte dhe kërkon standarde të përshtatshme për përgatitjen dhe ndërtimin	
Shpenzimet e llogaritura		
Totali		8,750,000 Lekë
Personi i kontaktit për projektin Drejtorja e Urbanistikës pranë Bashkisë		
Koha e zbatimit Viti 2006	Periodha e pritjes së rezultatit 2007 e në vazhdim	



Nr 109	Projekti Q5:O4:PG1:p1: Ndërtimi i shtëpive sociale me qira të ulët ose çmim të ulët	Lloji i programit Q5:O4:PG1: Strehim për të gjithë
Përshkrim i shkurtër i projektit Ky projekt, ashtu si edhe të tjerët nën këtë program, synon në reduktimin e problemit të strehimit për shumë familje të pastreha ose me të ardhura të pakta në qarkun e Durrësit. Nevojat e këtyre familjeve janë të shumta, por seria e këtyre projekteve do të reduktojë problemet e tyre akute. Ndërtimi i këtyre shtëpive do të ndërmerret në përputhje me standardet moderne dhe me buxhetin e planifikuar.		
Rezultatet e pritshme Reduktimin i problemit të strehimit	Grupet e synuara Familjet të pastrehët Familjet me të ardhura të pakta	
Aktorët e mundshëm Bashkia Donatorë	Kontribuuesit e mundshëm në projekt Bashkia Zyra e Planifikimit të qytetit	
Para kushtet Sigurimi i fondeve	Faktorë rrezikues Mungesa e vendeve të ndërtimit	
Shpenzimet e llogaritura		
Totali		200,000,000 Lekë
Personi i kontaktit për projektin Drejtorja e Urbanistikës pranë Bashkisë		
Koha e zbatimit 2005 e në vazhdim	Periudha e pritjes së rezultatit Mbas çdo ndërtimi të ri	

Nr 110	Projekti Q5:O4:PG1:p2: Ndërtimi i 24 apartamenteve për të pastrehët	Lloji i programit Q5:O4:PG1: Strehim për të gjithë
Përshkrim i shkurtër i projektit Transformimi i mjediseve në apartamente do të ndërmerret duke zbatuar të gjithë standardet e kërkuara për një strehim modern. Ky projekt do të përfshijë në punët e tij rregullimin e mureve ndarëse, suvatimin lyerje me hidromat brenda dhe jashtë, izolimin e tarracës dhe instalimin e sistemit elektrik. Pas kësaj pune, apartamentet do të jenë tërësisht funksionale.		
Rezultatet e pritshme Reduktimin e problemit të strehimit		Grupet e synuara Familjet të pastrehët Familjet me të ardhura të pakta
Aktorët e mundshëm Bashkia Donatorë		Kontribuuesit e mundshëm në projekt Bashkia Zyra e Planifikimit të qytetit
Para kushtet Sigurimi i fondeve		Faktorë rrezikues Koordinim i dobët ndërmjet aktorëve
Shpenzimet e llogaritura Totali 340,000,000 Lekë		
Personi i kontaktit për projektin Drejtorja e Urbanistikës pranë Bashkisë		
Koha e zbatimit Viti 2005		Periudha e pritjes së rezultatit Mbas çdo ndërtimi të ri



Nr 111	Projekti Q5:O4:PG1:p3: Transformimi i ndërtesave publike jofunkionale në ambiente banimi	Lloji i programit Q5:O4:PG1: Strehim për të gjithë
Përshkrim i shkurtër i projektit Ky projekt synon në strehimin e familjeve të varfra që jetojnë brenda territori të ish Uzinës Kimike në Porto Romano. Fondet për rehabilitimin e kësaj zone janë dhënë nga Banka Botërore dhe tani është përgjegjësi e Bashkisë së Durrësit sigurimi i strehimit për familjet që jetojnë në këtë zonë. Kthimi i ndërtesave të vjetra dhe të ndotura në zona banimi do të bëhet duke ndërtuar mure, duke rregulluar dyshemenë, duke bërë suvatimin, punimet hidraulike, izolimin e terracës, lyerjen dhe instalimet elektrike. Mbas realizimit të këtij projekti apartamentet e reja do të bëhen për këto familje një vend i rehatshëm për të jetuar.		
Rezultatet e pritshme Ulja e numrit të familjeve të pastreha Përmirësimi i kushteve të jetesës për banorët e zonës		Grupet e synuara Të pastrehët
Aktorët e mundshëm Bashkia Donatorët		Kontribuuesit e mundshëm në projekt Bashkia
Para kushtet Ndërtesat janë në pronësi të bashkisë		Faktorë rrezikues Mungesa e fondeve Kosto e lartë e investimit
Shpenzimet e llogaritura Totali		6,000,000 Lekë
Personi i kontaktit për projektin Drejtorja e Urbanistikës pranë Bashkisë		
Koha e zbatimit Dhjetor 2007–Mars 2008		Periodha e pritjes së rezultatit Prill 2008 e në vazhdim

Aneksi 1: Shkurtime e përdorura në matricën e zbatimit

AAU	Arkeologë, Arkitektë dhe Planifikues Urban	ISSh	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
AI	Ambasada Italiane	K	Komuniteti
ALI	Agjencia për Legalizimin e Ndërtimeve Informale	K14	Komuniteti Nr. 14, Durrës
AP	Autoriteti portual, Durrës	KA	Komuniteti i Artit
ATD	Agjencitë Turistike në Durrës	KB	Komuniteti i bashkisë
AU	Agjencitë e Udhëtimit	KBV	Komuniteti i biznesit të vogël
B	Bankat	KESH	Korporata Energjitike Shqiptare
B	Bashkia e Durrësit	KESH D	KESH, dega Durrës
BB	Banka Botërore	KKB	Komuniteti Kombëtar i Biznesit
BN	Bizneset e ndërtimit	Kom	Komunat
BP	Biznese Potenciale, NVM	KSD	Klubi i sporteve Durrës
BPP	Biznese potenciale të prodhimit	KST	Klubi Sportiv “Teuta”
BT	Bizneset e Turizmit	LA	Artistët vendas
BV	Komuniteti i biznesit vendas	MA	Muzeumi Arkeologjik
BVN	Bizneset vendase të ndërtimit	MASh	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
BZI	Bizneset e Zonës Industriale	MBU	Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit
BZP	Komuniteti i biznesit të zonës së plazhit	MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
Coplan	Instituti për Zhvillimin e Habitatit	MM	Ministria e Mjedisit
D	Donatorët	MRrTT	Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit
DA	Department i Arkeologjisë, Durrës	Ms	Mësuesit
DAR	Drejtoria Arsimore Rajonale	MT	Ministria e Transportit
DH	Drejtoria e hekurudhave	NSh	Ndërmarrja e Shërbimeve Bashkiake
DhTI	Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë	OJF	Organizatata Jo-Fitimprurëse
DMD	Drejtoria e Muzeumeve, Durrës	P	Nxënësit
DRT	Drejtoria Rajonale e Tatimeve	PAT	Programi i Asistencës Teknike
DZhb	Departamenti i Zhvillimit, Bashki	PD	Punëmarrësit e Durrësit
FK	Fëmijët e komunitetit	PT	Pasagjerët e Trenit
FShF	Federata Shqiptare e Futbollit	PuD	Punëkërkuarit e Durrësit
FVD	Federata e Volejbollit Durrës	PUM	Programi i Fondacionit Holandez Fokusuar në Zhvillimin e Biznesit
FZSh	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	PV	Prodhuesit vendas
GA	Grupet e aktorëve	PZ	Programi Zvicerian
GAT	Galeria e Artit, Tiranë	QF	Qendra e fëmijëve
H	Studiuesit e historisë dhe të kulturës	QK	Qendra e kulturës
IA	Instituti Arkeologjik	QKM	Qendra kulturore “A. Moisiu”
IMK	Instituti i Monumenteve të Kulturës	RV	Rinia vendase
IS	Institucionet Shtetërore	S	Studentët



SB	Stafi i bashkisë	Swiss	Swiss Contact
SDZh	Stafi i Departamentit të Zhvillimit	T	Turistët
ShB	Shoqatat e biznesit	TP	Të Pastrehët
ShHD	Shoqata e Hoteleve dhe Restoranteve Durrës	UNDP	United Nations Development Program
ShKN	Shoqata Vendore e Kompanive të Ndërtimit	UNESCO	United Nations Educational, Scientific and Cultural Organisation
ShLA	Shoqata Lokale e Arkitektëve	UNOPS	United Nations Office for Project Services
Shm	Shoferët e makinave	UP	Universiteti i Parmës, Itali
ShM9	Shkollat e mesme dhe 9- vjeçare	ZRP	Zyra Rajonale e Punës
SV	Sportistët vendas		

Aneksi 2. Raporti mbi “Anketim mbi Mjedisin në të cilin kryhet biznesi në qytet”

Hyrje

Anketimi i Biznesit për të cilin bën fjalë ky raport u krye në periudhën Mars-Prill 2004. Qëllimi i anketimit ishte që të ofronte një burim informacioni për procesin e planifikimit të zhvillimit ekonomik vendor në Bashkinë e Durrësit. Në të njejtën kohë, mënyra me të cilën u krye studimi do të përbente një eksperiencë më tepër për Bashkinë dhe veçanërisht për zyrën e zhvillimit.

Raporti paraqet një përmbledhje konçize të gjetjeve kryesore të dala nga studimi. Bashkë me këtë raport është përpiluar dhe një raport më i gjërë, në të cilin krahasohet performanca e të pesta bashkivë subjekt i programit DELTA. Po ashtu dhe të dhënat e mbledhura nga studimi janë vënë në dispozicion të bashkive në një dokument elektronik. Kjo krijon mundësi për të bërë analiza të tjera më të detajuara sipas nevojës përkatëse.

Ky anketim, i cili u analizua nga Z. Gent Dakoli, u krye në bashkëpunim me drejtorinë e zhvillim koordinimit pranë Bashkisë Durrës ku një ndihmesë të veçantë dha Shefi i Kabinet të Kryetarit të Bashkisë Z. Indrit Puteci dhe Z. Gani Buka, Kryetari i Dhomës së Tregëtisë dhe Industrisë Durrës, i cili ofroi ndihmë të drejtpërdrejtë në kontaktimin e bizneseve të medha, mbështetur nga ekspertët e FLAG Z. Artan Rroji dhe Erind Kraja.

Përshkrimi statistikor i grupit të bizneseve të intervistuar

- U intervistuan 96 biznese, të cilët përbëjnë rreth 3% të bizneseve të regjistruara në Bashkinë e Durrësit. (3019 të regjistruar në bashki.)
- Personat e intervistuar kishin pozicionet që vijon: pronarët në 75 biznese; drejtorë të përgjithshëm në 8 biznese; menaxherë të rëndësishëm në 13 biznese.
- 23 nga bizneset e intervistuar kishin një pronar; 73 kishin më shumë se një pronar.
- 26 nga bizneset e intervistuar ushtronin aktivitet prodhues; 25 aktivitet tregtar; 31 në fushën e shërbimeve dhe 14 në fushën e ndërtimit.
- Hapësira kohore gjatë së cilës bizneset kishin ushtruar aktivitet varioje nga 1 deri në 13 vjet. Shumica dërmuese e bizneseve të intervistuar kishin ushtruar aktivitetin nga 4 deri në 8 vjet.



- 52 nga bizneset kishin më pak se 5 të punësuar; 19 kishin 6 deri 10 të punësuar; 16 kishin 11 deri në 50 të punësuar; 7 kishim 50-200 të punësuar dhe 2 kishin më shumë se 200 të punësuar.

Faktet kryesore përmbledhëse që dalin nga studimi

Opinionet lidhur me klimën e biznesit në Durrës.

- 46% e bizneseve deklarojnë se është e vështirë për të gjetur fuqi punëtore të kualifikuar; ndërsa 50% deklarojnë të kundërtën. (Pyetja 9.)
- Bizneset deklarojnë se kanë mangësi në të gjitha fushat. Më të spikaturat janë: 16% në fushën e marketimit dhe shitjeve; 15% në fushën e aftësive teknike dhe 15% në fushën e menaxhimit. (Pyetja 10.)
- 60% e bizneseve deklarojnë se konkurrenca kryesore iu vjen nga bizneset vendore. (Pyetja 11.)
- Shoqatat e biznesit që kanë njohje në komunitet janë Dhoma e Tregtisë 34.5% e të intervistuarve dhe Shoqata e Ndërtuesve 19% e të intervistuarve. (Pyetja 13.) Shoqatat e tjera janë thuajse të panjohura. (Pyetja 22.)
- Tre faktorët kryesorë që e pengojnë biznesin të zgjerohet janë: taksat e larta 45.3; infrastruktura 42.1% dhe energjia elektrike 35.8%. Por dhe konkurrenca informale dhe kostoja e lartë e financimit përmenden me frekuencë të lartë. (Pyetja 15.)
- 20% e bizneseve deklarojnë se iu nevojiten më pak se 10 për të rinovuar licencat për vitin pasardhës. 40% e bizneseve duan nga 10 deri në 40 ditë. (Pyetja 16.)
- Marrëdhëniet me qeverinë vendore shikohen si problem pothuajse në të gjitha aspektet. Tre problemet më të mëdha janë: 90% korrupsioni dhe praktikat ilegale; 75% konkurrenca nga sektori informal dhe 68% harxhohet shumë kohë me autoritetet vendore. (Pyetja 17.)
- Mbi 90% e bizneseve deklarojnë se janë inspektuar më pak se 3 herë nga autoriteti i tatim taksave. 11% deklarojnë se i janë vënë gjoba dhe 5% kanë paguar rryshfet për autoritetin e tatim taksave. (Pyetja 20.)
- Vetëm 22% e bizneseve deklarojnë se ambjenti në të cilin kryhet biznesi në Durrës është keqësuar gjatë tre vjetëve të fundit. (Pyetja 33.)

Pritshmëria e bizneseve

- 36% e bizneseve deklarojnë se planifikojnë të zgjerohen jashtë bashkisë. 31% planifikojnë ta zgjerojnë aktivitetin e tyre brenda bashkisë. (Pyetja 8.)
- Tre pritshmëritë më të përmendura janë: 42.1% të përmirësohet infrastruktura; 24.2% të përmirësohen procedurat dhe 23.2% të reduktohen taksat si dhe bashkia të ofrojnë ekspertizë. (Pyetja 18.)
- Mbi 90% e bizneseve do të ishin të lumtur të rinovonin licensar brenda 10 ditëve. (Pyetja 16.)

Njohuritë e biznesit lidhur me funksionet e bashkisë

- 70% dhe 67% e bizneseve deklarojnë se nuk kanë dijeni për rolin e DZhE Bashkisë dhe DZhE Qarkut respektivisht. (Pyetja 22.)
- 46% e bizneseve nuk dinë lidhur me shërbimet private profesionale. (Pyetja 22.)
- Pjesëmarrja në përgjigjet e pyetjeve që kanë të bëjnë me departamentin në bashki që ndikon pozitivisht apo negativisht në biznesin e tyre është e ulët, rreth 35%. (Pyetjet 24, 25.)
- Vetëm 11% përmendin një departament të bashkisë që merret me zhvillimin ekonomik vendor. (Pyetja 26.)

SWOT

Pikat e forta

- Pozita gjeografike. Kjo ka lidhje me të qënurit qytet buzë detit, me toka të pasura bujqësore, me vende turistike etj.;
- Burimet natyrore dhe turistike veçanërisht arkeologjike;
- Porti dhe bregdeti;
- Rritja demografike;
- Klima e mire.



Mundësitë

- Qytet me rëndësi strategjike në zhvillimin e vendit; portë hyrëse në korridorin VIII;
- Prania e bizneseve të fuqishme dhe me eksperience;
- Shumë prej pritshmërive nuk kërkojnë shpenzime të mëdha financiare për tu bërë realitet;
- Shumica lidhet me përmirësimin e procedurave.

Pikat e dobëta

- Infrastruktura;
- Mungesa e energjisë elektrike;
- Politika e taksave;
- Afërsia më Tiranën; shumë biznese e shohin këtë si faktor pengues, por ka dhe nga ata që e shohin si faktor pozitiv.

Kërcënimet

- Ekonomia informale; ky është një nga faktorët që ndikojnë më shumë për keq në bizneset e regjistruara;
- Një numër i konsiderueshm biznesesh mendojnë ta zgjerojnë aktivitetin jashtë bashkisë;
- Korrupsioni; në pyetësor ky faktor është përmendur shumë herë si një pengesë e madhe;
- Reziçu për të humbur dëshira e bashkëpunimit të biznesit me bashkinë; kjo lidhet me imazhin e varfër për qeverinë vendore.

